

Ne,
studentet...



BSH-93-12

N 36

BIBLIOTEKA E RINISË

NE, STUDENTËT...

ANTOLOGJI

me vjersha e poema të studentëve

43432
13908

~~BIBLIOTEKA E SHTËPI~~
~~SHTËPIA BOTONJSE~~

SHTËPIA BOTONJSE «NAIM FRASHËR»

**KËNGË PËR ATDHEUN, PARTINË
DHE SHOKUN ENVER**

YLLI ZAHO

VARGJE PËR PARTINË DHE SHOKUN ENVER

Parti!

Në 25 vjetorin tênd,
unë, studenti,

çobani,
punëtori,
ushtari,

unë, malësori,
dua të të dhuroj ty një këngë,
një këngë të thjeshtë shqipëtare
thurur me çifteli.

Se biri i Sopotit s'të desh dekorata
si «Baballarët e Kombit» dikur.

Sharkun e stani,
revolen brezit,
një copë bukë misri

e «Manifestin»

në trastën e lëkurtë të «Usta Hasanit¹»).

¹⁾ pseudonim i shokut Enver Hoxha

Dhe shkonte Ai nga dera në derë
opingat t'i arnonte Shqipërisë,
se luftrat, regjimet e gurët
ja kishin çjerrë,

pra, duheshin ndrequr
për ditën e nesërme të lirisë.

Dhe ishte Ai
që ndërroi katedrat, sallat, leksionet
me kasollet me kashtë e mbledhjet ilegale.

Pra, ishte Ai
që hodhi në sup pushkën e gjatë,
bijën e ligjëshme të këtyre maleve.

Parti!

Vargjet e mia për ty
i dua të thjeshta,
i dua punëtore,
me kominoshe veshur,

jo me këpucë llustrina
e republikën ngjeshur.

Vargjet i dua të forta,
si pushka e malësorit,
si pistoleta e minatorit.
I dua vargjet kooperativiste,
me kazmë në dorë,
maleve taracave,

aksiонисте,
тë gatshme kurdoherë,
që Shqipërinë ta kthejnë në rivierë.

Parti!

Dua dhe unë
të vë në themelet e tua 25 vjeçare një gur.

Një gur,
një pushkë,
një varg,
një zemër,
zemrën time.
Kjo është për ty, parti!
Një pushkë bri piramidës në kufi.

ZHULJANA JORGANXHI

MOSHATARES REPUBLIKE

Sot mbushim nëndëmbëdhjetë vjet,
të dyja kemi lindur në një ditë
dhe u përkundëm nga një dorë,
dhe u përkundëm në një djep,
moj moshatarja ime
Republikë.

U rrite ti... dhe unë s'mbeta pas,
dhe buzëqesh toka jon' epike.
Me hapin tënd gjithmonë
çdo hap unë do ta mas,
binjakja ime Republikë,
dhe do të rendim ne kështu
ndër mote.

Në sup një pushkë,
në dorë kazm' e libër.
Si gjithënje na prin një dor' e fortë,
moj bukuoshja ime
vështrim-çiltër.

PARTISE

Vargun poeti me afsh krijon
për ty që n'dej na solle gjak t'ri.
Bukur rapsodi hymnet t'këndon
Me çifteli.

Ti je frymëzim për zemrat shqiptare.
Ti je burimi i s'ardhmes sonë.
Ti sogje je për tokë amtare,
o nana jonë!

E ndaj nga zemra shpërthën gëzimi
për ty, burrneshë, që s'din q'asht tuta,
që n'anmik hidhesh si re thëllimi
ndër t'rreptat skuta...

ENVERITÀ

U linde,
kur populli rënkonte,
kur mëm' e dashur —

Shqipëria —
vuante;

u rrite në rënkimet e jetës
së popullit tënd.
(Mbérthyer prej vdekjes,
trupi i gjakosur
i shqipes krenare
nën thundrën armike!)

Dhe more rrugën e lavdisë
me pishtarin ndriçonjës,
rrugën e lirisë.

Kur korbi
gjak shqipe kërkonte
e gjaku i shqiptarit
ndër deje po blonte
për të shenjtën liri,

Ti ngrite një natë
mëmën tonë parti.
Zemrat peshë u ngrite
trimave shqiptarë
e në luftë u prive
për vite me radhë.
E sot,
flamuri marksist
qëndron i papërlyer,
në shtizë të çelniktë,
lart i mbërthyer.

FAIK DEDA

Shumë shqiptarët i
dënsq i ëndot nënëtëm
nëpër u bëdoq taniçët
kunëtëpëre e synuari
vërtet u bëjti që
në këtë em offrët
joa Z
lazadurit përmes
Partisë i qëndrës
qëndroj si shqiptarët
në vendlindjet i duhet

Partia jonë e Punës,
filtër i pashoq i ndjenjave
dhe qëllimeve më të larta...

Për sytë e shqiptarëve:
kaltërsi e thellë përgjithmonë,
ku syt' e armiqve verbohen.

Aorta vigane e zemrave të pastra,
që tek ti farkëtohen!

roksimri si IT qëdojë zëllajt e
mirëqen si qajebat at mëson si që
mëson agj i lëviz urbund e agj taksat si
mëjë oby mijëd si frot njezit rre
uzif i Shkodrës mëdojn si këndësi oby zo
zot gjithashtu at roksimi i që

TË DASHURIT ENVER!

1

Ti je për ne gjithmonë po aq i ri,
dhe s'duam të besojm' se thinja të zbardhoi
rreth ballit tënd të rrahu nëpër shqota,
që burrerin' e kombit lartësoi
në majat ku i heq kapelet bota,
së moçmes, së paepurës Shqipëri.

2

Drejt shtigjesh, ku gjenia jote shndrit,
nuk ka rrebesh që të na trembi synë
n'atdheun që stoliset çast e orë;
partia-nënë: mendimi, gjaku ynë!
M'e madhja nëpër shekuj kjo kurorë,
që komunizmit namin po ja rrit.

Me fjalën tënde Ti na frymëzon
 dhe na mëson ta ndajmë pa ngurrim
 të zezën nga e bardha, mikn' nga armiku;
 për idealin ton' të bëjm' çdo flijim,
 në çdo rrethan' të njohim q'është i ligu
 dhe si kërkon ta ndalë vrullin tonë.

Ne ecim ballëlartë në shtërgatë.
 Përmes shikimit tënd dhe për çdo ditë
 të ardhmen aq të ndritur e vështron
 ky popull, që lavdin' partisë ja rrit;
 e pastër dashuria që s'shteron,
 si zemrat, dhe sa qielli e pamatë!

Shikimi i atij shtërgut është një gjithë përfitë
 Gjave lidhët e më 30 devedhëtë së shumë¹
 qëndrojnë e rregulltët e qaribët
 Duk i mësim jashtëm e mësim-çurrim
 qëndrojnë e rregulltët e qaribët
 qëndrojnë e rregulltët e qaribët

KENGË PËR PARTINË

Partia,

manivel që vë pérjetësish në lëvizje
ndërgjegjen tonë.

Dhe ne e ndjejmë veten të rinj gjithmonë,
dhe Shqipëria mbetet pérjetësish e re,
dhe ecim drejt,

pérpara,

ajo

dhe

ne.

Parti,

edhe këtu,

në kantierin zhurmëmadh të poezisë,
më solle ti.

Shpesh e kam pasur vështirë,

shpesh dhe kam mbetur diku,

por ti

më je gjendur aq shpejt pranë.

Mendimet e mia

vinin

e ngarkoheshin tek ti,

dhe e kisha më të lehtë,

dhe vazhdoja rrugën përsëri drejt.

MOSHATARËVE TË ATDHEUT

Në ishim të parët,
që lindëm në të parën pranverë të lirë
të atdheut tonë.
Pranverë e lirë!
Veç në quell akoma lundronin re:
plagët e luftës,
mungesat e ditës
grahmat e së vjetrës.
Djepat tanë të nxirë
ende qëndronin përdhe.
Rrezet e nxehta të diellit
na binin mbi fytyrë,
e kudo...
Ne ecnim mes rrezeve,
duke qeshur e lojtur me to,
duke lojtur me të vetmen lodër që kishim,
duke lojtur me agimin e së ardhmes.
Qeshjet tona të bardha —
e vetmja stoli
e mureve hijerëndë të së vjetrës shtëpi.
Ish akoma herët
dhe vështirë, shumë vështirë.
Baballarët mbrëmave

~~43432~~ 13908

MINUTERIA E SHETTA
GIRROJASIN

RAMAZAN HUSHI

ATDHEU

Çdo herë, atdhe, do sulemi pas thirrjes tënë,
ashtu, me nxitim,
këpucët pa i veshur mirë...

Krenarë, madhështorë, si tinguit e një këngë,
do kalojmë çdo mur që kemi për të ndeshur.
Në u dashtë që kjo këngë t'i dalë anekënd botës,
do t'u biem më fort istrumentave tona,
që kur të kalojë në mes të shiut e sqotës,
të kuptojnë të gjithë: kjo këngë është jona!

QYTETI IM

Qyteti im thinjosh,
qyteti im djalosh!

Një thinj' e bardhë lashtësie
në kokën e zbardhur të atdheut,
muskul plot jetë, që s'ka të lodhur,
në trupin muskuloz

të Shqipërisë së re.

Buçim sirenash
e mbartës i miqësisë.
Ja ç'është qyteti im,

Durrësi thinjosh
Durrësi djalosh.

PËR REPUBLIKËN

A të kujtohet kur linda,
Republikë?

... Tymi i luftës ende s'ish larguar;
Era e barutit ende vazhdonte...

Drurët e çative, urat varur...

Qytete e fshatra të tëra rrënuar.

... Por liria kish ardhur,
Dhe me vete si prikë,
Të solli ty,

Republikë!

Një ditë atdheu ishte në festë
Nga gjoksi i shqiptarit, shpërtheu gëzimi:
Brohoret i vogli,

i madhi,

Brohoret fshatari,
Brohoret qytetari —

Ishte 11 Janari.

Ishte ajo ditë

Plot thirrje:

Republikë!

Republikë!

Republikë!

Ajo ditë
Kur u kalit në kufijtë
Republika Popullore e Shqipërisë.
Eh si u tërbuan armiqjtë.
Veten e hëngrën me dhëmbë.
Të çmendur plane hartuan;
Me mijëra herë u betuan...
Por ti madhështore marshoje;
Pa frikë
duart e hekurta
partia,
populli,
ishin me ty,
Republikë.
Sot të festojmë ditëlindjen,
Republikë 21-vjeçare;
të veshur me kominoshe,
në qytete, fusha e male;
kazmën në dorë,
pushkën krahëve.
Së bashku do zëmë një valle.

GEZUAR VITIN E RI!

Mesnatë,
Gotat trokasini...
Gëzimi është rrezatuar anë e kënd
«Gëzuar vitin e ri!»
Këtë çast dua të jem
aty në tavolinë:
me ushtarin,
kufitarin,
që vigjilojnë për Shqipërinë.
Në emër të atdheut
t'i uroj:
«Gëzuar vitin e ri!»
Me punëtorin:
në kantiere,
diga,
pallate,
fabrika,
uzina,
minierë.
E nga zemra të nxjerr:
«Gëzuar, vëllezër,
gëzuar
me mijëra herë!»
Atje, bashkë me shkrimtarin,

dhe ta uroj për romanin;
me kompozitorin,
piktorin,
Që tablo punuan dhe këngë
për popullin, partinë nënë;
me mësuesin e vjetër e të ri,
që breza të tërë
brumosin, edukojnë
në Shqipëri.
Në malësi
të shtrohem me malësorin
e t'i uroj:
— I paç prodhimet si deti!
Po dhe një herë ta trokas
me atë që, nga qyteti,
erdhi këtu në malësi
e «Të lumtë!» t'i them,
«Sa këto male rrash dhe til!»
Dhe kudo dua të jem,
në tavolinat ku pinë,
e me ta të trokas gotën
për atdhenë

Enverin

partinë.

VANGJEL STEFA

namtari i kultura si ekip

kontaktoj e m

zgjidhje

qytetarët e

shqipërisë

shqipërisë shqipërisë

shqipërisë shqipërisë

shqipërisë shqipërisë

shqipërisë shqipërisë

shqipërisë shqipërisë

AT DHEUT

namtari i kultura si ekip

kontaktoj e m

zgjidhje qytetarët e

shqipërisë shqipërisë

Të ndezur flakë,

mbi ty shekujt kaluan,

Shqipëri!

Ballëhapur, si shqiponjë qiejve,

përpara ti çave.

Zjarret e shekujve të farkëtuan.

Bijt e bijat, krenaria jote,

u bashkuani.

Radhët fort shtrënguan.

I prirë nga partia, ky karvan

i hekurt,

i etur për liri,
godiste,
shembte . . .

Liri ose vdekje!
Mbi truallin tënd,
atdhe,

mbi borën e ngrirë,
gjaku,

rrëke,
epopenë shkruante.

Dhe flamurin e lirisë,
flamurin e vegjëlisë,
në Nëndor,

hipur mbi piedistal,
ngrite krenar.

E sot,
drejt socializmit
dhe komunizmit

rrugën ti çan.
me hap revolucionar.

KËNGË PËR HERONJ

PERLAT REXHEPIT

Lapidarë!

Si piketa të socializmit
vjetet ju vendosën anembanë Shqipërisë.

Për çdo mëngjez,
të zgjuar të gjej, Perlat,
krenar, të patundur, gjoks-hapur, ballë-lartë.
Vështrimin tret drejt atdheut, larg,
përshëndet hidrocentralet gjigante
dhe kodrat me taracat varg e varg.

Me vdekjen u ndeshe, Perlat,
flakë për flakë,
dhëmbë për dhëmbë,
dhe Shkodrën e ngrite në këmbë.
Por s'vdiqe,
ti ecën, Perlat,
kurdoherë ballë-lartë.
 me guxim, si lab, si trim.

ASHTU SI ADEM REKA

Biga do përleshet ndër tufane
e valët do përplasen nëpër shkrepë,
i fortë do ngrihet zëri ndër uragane:
«Qëndroni, shokë, ashtu si Adem Reka»

Vaporët tanë detet po çajnë,
me ballët-çelikë sulmojnë stuhinë,
në bordet e tyre Ademin e kanë,
në zemrat-motorë ruajnë partinë.

Shtërngata përplaset në brigjet shkëmbore,
i qetë Sazani buzëqesh në perëndim,
e vitet kalojnë përmbi lapidare,
e qëndrojnë ata, gjithë në shkëlqim.

PËRMES FLAKËS

Përmes flakës zgjaten katër duar,
përmes flakës çajnë katër sy.

— Shpejt! Më shpejt, se nafta do shpëtuar, —
thrrasin e vrapojn' ata të dy ...

Tymi, flaka, shtohen gjithnjë shtohen
larg të djeg fytyrën afsh' i nxeh të,
por në mes të flakës do dëgjohet
fjal' e komunistit Muhamet.

Gjokse naftëtarësh po luftojnë,
për detyrën digjen sot ata,
gjakun industrisë i shpëtojnë
trimat Muhamet e Myrteza.

Meti, tash mes shokësh i rrrethuar,
për të fundit herë po u flet,
një dëshirë ka për t'u treguar,
për partinë ka një amanet:

Teserën që i kish dhën' partia
shokët komitetit t'ja dorzojnë
Dhe ta din' të gjith' se Shqipëria
Do të lind' e rritë veç heronj.

KËNGË PËR VULLNETARËT

NIKO DAKO

AROME PISHASH

*Shokëve tē mi,
pjeshëmarrës në aksionet e
rinisë.*

Me kokë tē zbardhur nga pluhur' i rrugës,
në çantë një libër tē ri,
së largu po vij unë, biri i jugës,
tek ti, e rrepta malsi!

Dikur më qëlloi tē rroj në mes malesh,
ku jetën fillova ta njoh,
prandaj s'jam i zoti që mos tē përmallem,
kur male tē larta prap' shoh.

Përrenj mjekërbardhë, me ujë dëbore,
dredhojnë plot shkumb' e buçim,
çdo pishë, me moshën e vet shekullore,
kurorën lëkund me përtim.

Dhe roja, e pyllit me pushkë mbi sup,
që zbret nëpër lugje e ujvara,
dhe shqipet mbi shpina vargmalesh më duken
një pjes' e tablosë shqiptare.

... Me kokë të zbardhur nga pluhr' i rrugës,
në çantë ca ndresa, një libër të ri,
po vij vullnetar unë, biri i jugës
tek ti, e rrepta malësi!

Qetsin' e pyllit të pamatë
një tjetër melodi e prish:
gërvim' e ngjirur e lopatës,
goditje kazmash e qysqish.

Si një shirit me ngjyra t'larme
lëvrin brigada e rinisë,
ndrit dielli tehun e çdo kazme
midis shiritit që lëviz.

Dikush ka hequr kanatierën,
sulmues do të shpallet sot ai
si buldozer që çan përpara,
taraca hap e mbjell hardhi.

Lidh me shami një vajzë duart,
të vrarat duer prej lopate:
— Ësht' her' e parë... s'jam mësuar... —
e formon gropka nëpër faqe.

2

Tek ne, në skuadër, ka ardhë xha Froku,
rojtari i heshtur dhe plak,
kutinë i zgjat me radhë çdo shoku,
të dredhë duhanin kaçak.

Dyfekun mes gjunjësh e mban të shtrënguar,
si nervin e jetës së tij,
dhe ngjan sikur shekuj kështu ka qëndruar
mbi këmbët e forta ai.

Tregon historira, hedh thënie të urta
dhe qesh pak çudiçëm ndën buzë,
pa shpesh studenteshat me duart e buta
i nget me shaka dhe romuzë.

Pushim... pushim një çerek ore,
t'i lemë kazmat në qetsi;
shpërndajnë pyjet mirditore
erë rrëshire ane freski.

Përtej rrjedh prroi i nxituar
nëpër lëmyshk e ndër shkëmbinj,
me etje gryk' e përvëluar
të akulltin ujë thëthin.

Vajza zeshkane afrohet lehtë
e nxjerr nga çanta djath' e bukë,
ngadal' përtypen dy — tre vetë,
më tej dikush gdhend një çibuk.

Nis pylli rishtas të ushtojë
sikur shpérndan freski fuqi,
se puna prapë do të vlojë
në mes shkëmbinjve përséri.

3

Rrjedhin ditët nën tinguj lopate,
shpérthen mina e gurë copton
e çdo metër i rrugës që zgjatet,
djersën tonë q'u derdh na kujton.

Prap' xha Froku na erdh tek punonim,
kishte qejf që me ne të djersinte,
shihte rrugën e re si dredhonte
dhe qeleshen mbi vetulla vinte.

... Dhe në orët e lira, nën hije,
vullnetarët rrethojnë rojtarin,
qiftelisë xha Froku i bie,
shoku yn' i ka lën' dhe kitarën.

Mbi dy tela që dridhen aq lehtë,
po lëvizin të ashprit gishtinj,
bot' e gjerë, mbledhur ngajeta,
zbret nga kënga mbi rrudhat e tij.

Pastaj ballin e dirsur ngre plaku
dhe sikur thellë zemrat na sheh,
si t'i mbledhë mendimet së largu,
nis ja merr një ballade të re.

Heshtin shokët... s'pushon çiftelia,
këngët rendin si ujra përposh,
drurë e njerëz pushton melodja,
melodi që të bën të gëzosh.

Hesht rojtari... kitarën merr shoku,
nis vallzimi, vlon gaz në çdo gjoks;
ja, një vajzë çapkëne xha Frökun
kësaj radhe e fton për një foks.

Dhe si sot veten plaku kaq ngushtë
s'e ka ndjerë në jet' asnijëherë,
as kur natën nishan merrte me pushkë.
as kur udhën njeri i pat prerë...

Përmbi drurë dhe shtigje zbret nata,
«Gjumë t'embël», na thotë xha Froku,
hedh mbi supin prap' pushkën e gjatë
dhe humbet si kalim' i një zogu...

4

E thellë përreth nxin mesnata,
as yje, as hënë s'ndriçon,
e lodhur tani në baraka
brigada po fle, ëndërron.

Kur ndihet veç era dhe krojet,
në gjumë dikush flet përqart,
një zhurmë motori afrohet,
një zë hyn krevat më krevat;

dhe gjumi u dashka dëbuar,
megjithëse qerpiqët t'i mbyll,
bilbili po fryn pa pushuar:
«Alarm! Zjarr në pyll!»

I flakim ne tej bataniet,
djeg gjokset një vrull djaloshar,
secili prej shtratit shpejt ngrihet,
sikush e ndjen veten ushtar.

... Maqina mes territ çan para,
të gatshëm mbi të jemi ne
e këngët revolucionare
përhapen gjer larg pishave.

Përtej edhe qiellin skuq flaka
e trungjet lëpin e i fsheh,
me kazma, hanxhar e sopata
mes flakësh u futëm dhe ne...

5

Me duar që janë dhe rreshkur dhe nxirë,
me shpatulla thekur në erë e diell,
me zërin e pyllit që flet «lamtumirë!»
ky vend i atdheut ne sot na përcjell.

Ne s'erdhëm këtu si turist' kureshtarë
të gjejmë çudira në bjeshk' e malsi;
ne erdhëm të thjeshtë, që epopesë shqiptare
me djersë t'i shtojm' një kapitull të ri.

... Agim i spërkatur me erë rrëshire,
kurorën lëkundin përtej pishat varg,
ushtima e pyllit na jep lamtumirën
shaminë e kuqe tund dielli nga larg.

MARTE QESTERI

M A L L ...

Tek ti shpesh mendja po më rri,
e dashur nënë, natën kaq vonë,
më ngjan sikur që larg dhe ti
vjen hyn ngadalë në çadrën tonë.
Kur mbi çdo frymëmarrje nate,
si ketër hëna shket ndër drurë . . .
dhe unë, vajza jote «delikate»,
ty dorën ta shtrëngoj si burrë.

DUART E MIA

Të bardha i kam duart,
o shkëmb mijëvjeçar!
Po ti para meje aq rëndë mos u mbaj,
se duart «delikate» më dysh do të t'çajnjë,
se s'di unë me to vec leksione të mbaj,
në to mbaj mirë unë
dhe kazmën dhe pushkën,
që Ti, atdhe, të lulëzosh
për ditë.

STUDENTËT VULLNETARE

1

Mëngjezi shpërtheu, drita e furishme
ndezi në shkëlqim me mijra lule.
U zgjua kënga dhe eci kësaj rruge!
— Jetë! Mirëmëngjez! — Vrulli i rinisë
më rreh sot në deje më tepër se kurrë
dhe nis këngën e gëzuar me shokët vullnetarë.

2

Maqinat janë vënë në radhë për dy.
Maqina të heshtura, me targa të ndryshme,
maqina të mëdha qytetesh të ndryshme
shikojnë të qeta nga radha për dy.
Eh, ju maqina, maqina të qeta!
Do na ngrini ne, do na çoni ne
tutje, shumë larg, në viset e veriut,
ku rrjedh djersa lumë, ku gjëmojnë sharrat,
ku shpërthejnë mina, ku këndojnë gjinkallat,
ku aq fort djeg dielli, nanuriten valët,
ku rëndojnë kallinitë dhe çahen ugarët!
Eh, ju maqina, maqina të qeta!

Buçisni motora, lëvizni ju, rrota!
 — Lamtumirë shokë, lamtumirë!
 Dhe sheshi oshëtin nga përshëndetjet,
 mbi shesh hedhin valle brohoritjet,
 dhe këngët —
 marshet fitimtarë,
 përherë të rinisë bashkëudhëtarë —
 hapin rrugën.

— Lamtumirë shokë, lamtumirë!

Dikush
 fotografon harenë e madhe;
 një tjetër
 mbas maqinave vrapon të inçizojë,
 nga megafoni vijnë urdhëra;
 nga trotuaret
 përshëndesin nënët, baballarët;
 dhe flamurët —
 si gjithnjë në ballë fitimtarë!
 Të qetë janë vetëm muret e heshtur e të

shurdhër

Si dikur
 u nisën vullnetarët mes haresë,
 si dikur
 nisën marshimin këngët e rinisë,
 si dikur
 horizonteve dhe maleve ndizen zjarre,
 në aksione vullnetare,
 rinia studenteske shpërndan harenë e madhe
 si dikur!

MAKSIM KROI

U NISËN VULLNETARËT

Një shkurt
i viti 1967.

Të parët
u nisën për udhë
për të ndërtuar një tjetër hekurudhë
të gjatë,
të gjatë,
vullnetarët
në tokën e lashtë fushore,
shumë pjellore,
në Myzeqe.

O shokët e mi vullnetarë!

U frymëzuat ju
nga tribuna e lartë e kongresit fitimtar
ku udhëheqësi i dashur i partisë
i besoi këtë vepër të madhe
organizatës sonë të rinisë.

Dola kur u nisët,
me sy ju përcolla, me dashuri.
Shumë ju kam zili,

shoqe e shokë të rinj punëtorë,
fshatarë, ushtarë, shkollarë,
që me kazma e lopata në dorë,
me gëzim të madh atje po shkon
e me vrull të parët punën të filloni.
Mbas jush, me dhjetra mijë do të vinë, aty,
në punë,
e, në mes tyre, edhe unë.

Përse kam sot kaq shumë gëzim?
Se të ndërtojmë ty, atdheu im!
I bukur je, si asnje vend,
por më të bukur,
më të fortë do të bëjmë,
se rrithemi ne në klimën e pastër të partisë,
në gjirin e ngrohtë të Shqipërisë.

DUKE ECUR PËRMES FUSHAVE ME TREN

Ndryshoka sot ky tren i udhëtarëve,
sirena më shpesh fishkëllin,
traseja zgjatet pa mbarim arave,
kooperativisti tund drapërin e ballin fshin.

Me traktruket biseda merr zjarr,
kënga ushton te shkallët,
tej, mes grunjave, nga larg
kooperativistja përshëndet moshatarët.

Ndryshoka sot ky tren i udhëtarëve,
ndryshokan dhe traktruket mbi shinat,
një të moshuari mes vullnetarëve,
ç'po iu trazokan kujtimet.

Me shallin e aksionit gjak të ndezur
veten fort të lumtur e ndjen,
dikur shina montoi e baltë pat ngjeshur,
treni çan me traktruke, vagoni zjen.

GJITHË E DUAN KOMANDANTIN

Gjith' e duan komandantin,
ësht' m'i miri djalë,
ndonse s'bën në pun' lëshime
dhe të rrept' e ka fjalën.

Kur na nxehet me ndonjérin,
me duart e forta
si rrufe e shkrep kazmën,
thua tundet kodra.

Vajzat qeshin dhe jo rrallë
syt' andej i hedhin
— Forca, — buçet komandanti, --
Të arrijmë ledhin.

— Forca, shokë, se ky ritëm
fare s'na nderon.
Lefteri, tundu, të shkretën,
ç'ke që nusëron?! —

— Ti çfar' ke gjithmon' me mua,
s'gjete ndonjë tjetër? —

Ajo kthehet zemëruar
shoqet tutje qeshin.

COUM MISTER

Komandanti skuqet flakë,
s'gjen të thot' një fjalë,
e lëshon kazmën për tokë,
shkon përtej ngadalë.

Që së largu zë i ti
dëgjohet pas pak.

Gjith' e duan komandantin,
ësht' m'i miri djalë.

EH, SI ISHIN KÉTO KODRA!...

Eh, si ishin këto kodra
faqeve të pjerrta!
Mbushur ishin me murriza
dhe shkurre të egra.

Vullnetarët myzeqarë
kodrave iu qepën.
Pa shiko shpatet e kodrës,
duken sikur qeshin!

Si gjerdan fishekësh ngjajnë
ngjeshur përmbi shpatin,
ngjiten, ngjiten përmbi majë,
diellin do të kapin.

Jan' të bukra këto vende,
toka ësht' e mirë,
do lëshojë motin tjetër
kokrra dhe kallinj.

Që të qeshë Mallakastra,
bukën ta bëj vetë,

që këto vende të begata
të bëjn' tjetër jetë.

O moj fush'e Myzeqesë,
shiko bijt e tul!
Po punojnë sa për dhjetë
kodrave këtu,

që e nesmja komuniste
dhe këtu të ndrisë,
kodrës mbushur shkurre t'egra,
faqes me murrizë.

NE, VULLNETARET

Pér tokë buke, me shkamb u kacafytëm
nëpër suka që n'shekuj ishin djerrina,
bashkë me fshatarin n'banjo djerse u zhytëm
e shpërthyem mina.

Lëkurën e ngurtë kodrës ja xhveshëm,
pér brez kanal e n'trup hardhi i veshëm.
Gju n'gju me malsorin lahitën kurdisëm
e rapsodi nisëm.

PËRSHËNDETJE VULLNETAREVE

U dha sinjali
dhe krisi kënga,
simfoni e ditëve të reja.
Rinia ime e fortë dhe gazmore,
të pret tani mes fushave traseja!

Le të buçassë vrulli i pamatë
posi një det i gjerë që gjëmon.
Rini, rini e ditëve të flakta,
për ty në zemër kënga s'më shteron!

Kjo dora jote,
dorë e fuqishme,
ngul kazmën e parë në trasen' e re,
shoh si mbi djersë ecën e furishme
lokomotiva nëpër Myzeqe.

Ndjej si gjëmojnë kazmat anembanë,
mes fushave që zgjohen çdo agim,
brigadat rendin, tokën tej e çajnë,
s'ka gjë se era rreh me tërsëllim.

Na presin shinat,
zjejnë sot barangat,
dhe tokës ngulet kazma pa pra,
me gëzim urojnë dhe bien çangat:
«Punë tē mbarë, shokë vullnetarë!»

Dhe përmbi fushë
do tē shtrihet rruga
si një arter i hekurt dhe i ri.
Në shekuj do mbetet si gjurma
e madhështisë sate, rini!

VIKTOR QYRKU

A E DËGJONI, VULLNETARE TË RINJ?

A e dëgjoni, vullnetarë të rinj,
sirenën e gëzuar të trenit?
Flamuj të kuq fluturojnë sipër tij
dhe lulet e kopshteve të Fierit.

A e dëgjoni, vullnetarë të rinj,
sirenën e gëzuar si vërshëllen?
Mes fushave rrëshqet me brohori,
stacioneve të rinj,
i shpejti tren.

A e shikoni?

Nëpër binarë
rrotat këndoijnë monolog të ri,
vagonat ndjekin pas, posa ushtarë,
lokomotivën,
që çan me furi.
Fshatrat e qeshura,
kodër më kodër,
tundin flamujt e kuq me gëzim.
Ai rrëshqet në vende të panjohur,
i përshëndet të gjithë me vërshëllimë.

A e shikoni?

Gjith' fushat çelin lule
kur shkon ky tren,
që mbart aq lumturi,
dhe zemra bashkë me të sulet,
posi lejlek i bardhë përsipër tij.

A e shikoni, të dashur vullnetarë,
gë plot gëzim trasenë hapni sot?
Unë e shikoj në ballin tuaj krenar.
në këngën e kazmave
e dëgjoj.

E, HËNË, SI THUA?

Dielli
dhe unë,
djali i madh në ballkon.
Motra me një frysë fluturoi të porosisë
këpucë të lehta,
këpucë për aksion.

Babai i lodhur pi kafe dhe hesht,
sikur asgjë nuk ka për të thënë.
Hëna, mbi lagje,
si bukuroshe qesh.
Mirëmbërma, hënë!

Motra po kthehet
e lehtë si flutur.
Dhe tundka kaçilen si çupkë filloriste!
E, hënë,
si thua, o hënë e bukur,
do vish me ne edhe ti aksioniste?

MARSHOJMË E KËNDOJMË

Vargu i gjatë i të rinjve u nis në udhën e punës.

Mbi hendeqe vështirësish marshojnë.

Supet mbajnë kazmat,

sytë — buzëqeshjet,

buzët — këngën optimiste:

«Haj t'punojmë!»

Ngjitemi kodrave përpjetë,

shtigjesh të përbaltura,

ecim, lodhje s'ndjejmë,

kënga na rrëmben

me flatrat e hapura.

«Haj t'punojmë!»

Mbi ne hapet i pafund qielli.

Qielli i madh,

m'e madhe dashuria jonë.

Marshojmë . . .

«Haj t'punojmë!»

T A R A C A T

Malesh ushton kjo kënga jonë.
Brigadat tona, si çetat partizane,
kanë prurë ndër to sërisht gjallërinë.
Jemi vullnetarë!

Flamuri ynë qiellin e pastër rreh
dhe malet brohorasin krenarë.
Taracat zgjaten pa mbarim,

të gjera
të gatshme për prodhim,
si këngët tona këtyre ditëve — stuhi,
si e ardhmja jonë — buzëqeshje komuniste.

Taracat —

shkallë që, edhe maleve,

më lart
socializmi të ngjitet.

RRUGA E RINISE

Forcë e gjallë e rinisë
Përmes shkrepash gjarpëron
nëpër bjeshkët' e malësisë
dritë do çajë rruga jonë.

Nuk do ketë shtëpi maleve,
larg e larg e breg më breg
sepse neve pranë maiave
nepër shkëmb do hapim shteg.

Dhe shtëpitë që kanë mbetur
si simbol i vetëmisë,
mbeturin' e ndarjes vjetër,
do t'i lidh' rrug' e Rinisë.

KATUNDARE, KATUNDARE !

Pika e djersës sa i' bul' gishti
katundares po i pikon,
porse shatin, kap prej bishti,
sokolesha nuk e lshon.

— Hej, t'i vash' ti vash' e bardha.
Tashma punën pse s'e men
e me dal' me ndej' ke dardha,
ku pushim me shoqe gjen?

— Jo, se misri me krah' hapun
m'pret që rrajën t'ja liroj,
prandaj n'dor' kte shat kam kapun
dhe n'pik' t'zhegut e punoj.

— Të lumt' dora, moj puntore!
Faqebardh' ti dalsh ndër gara!
Bashk' me shok' e shoqe prore,
ti të jesh' gjithmon' e para.

SHOKËVE TË MI VULLNETARE

O shokë!
Ne lindëm
kur brigjeve të tokës së lashtë
iu ngulën kazmat e para,
e shinat,
si petka të reja, iu veshën Shqipërisë
në trupin e saj skelet
prej urisë.

Ne lindëm
kur «urra-të» e turneve,
që dilnin tuneleve,
u shkrinë me fishkëllimën e lokomotivës
e zhurmën e levave.

E fortë qe ajo fishkëllimë,
m'e fortë se zëri i hoxhës majë xhamisë,
m'e fortë se lutja e priftit
n'altarin e «shenjtë» të perëndisë.

Pra, erdhi dita
që Shqipëria s'do kërkonte mëshirë në
«paçavrat e tempujve»,

Fishkëllima e trenit
nga gjumi i rëndë do zgjonte
perënditë e mermerta
dhe Shqipëria
do t'u priste atyre biletë
për në fund të ferrit.

Moshatarja jonë,
nëndëmbëdhjetëvjecaria lokomotivë!
Ne republika na mbajti ngrohtë,
ne republika na dha gjinë,
së bashku ne buzëqeshëm
në gjirin e saj të çelniktë,
e sot ne asaj do t'i themi: «Mirëmëngjez!»
në Fier, Lushnjë e Rrogoshinë.

O shokë të mi, vullnetarë!
O ju që hodhët kazmën e parë!
Mos harroni!
Ne lokomotivës i jemi moshatarë,
ne republika sot na ka ushtarë.

KËNGA MOSHATARE

Pisha dhe male, male dhe pisha.
Heu, shpërtheni ju mendime të ciltra!
Nga jugu kam ardhur,
veç jo si re që pa drejtim shtyn era.
Si rrezja që pa tjetër do dali,
si lulja që patjetër do çeli
erdha...
Këtu zë fill Mati i rreptë,
dredhon mes pishash qindvjeçare
më ngjan se mbaj pér dore fijet
e kësaj mbrëmjeje shqiptare.

Del hëna vjedhur, si kunadhe,
pas trungut të pishave rri.
Një rapsodi të lashtë alpesh
dikush po derdh në çifteli.
Jehon' e këngës vjen tek unë
me shpata e kreshnik' të malësisë
E di,
pas vitesh, ndonjë tjetër
do këndoje aksionin e rinisë.

Flenë shokët. Mbi dhe është derdhur
vesë e ndritshme, e pafundme yjesh.

Era m'i mörgon mendimet larg
dhe, si köngët,
i shpérndan përmes pyjesh...
Vallë në qafë të këtij mali
përse ngrihen pishat
si jele të egërsuara kali?

Male me flokë të gjata pishe,
vraga mes shkrepash
si bisht i një bishe...
Ja malësia,
e ashpra, e buta,
si könga kreshnike që rrjedh nga lahuta!

Si u ndodhëm vallë në këto anë,
ku thesaret fshihnin malësitë?
Çelsi, që në dorë shekujt mbanin,
si u ndodh në duart e rinisë?
— Bjeri fort!
s'dëgjojnë eshtrat e thata
me pickime të lehta.
Duhen muskuj të fortë
dhe vegla të mprehta,
që t'i thërmojmë këto të ashpra eshtra!

Kush tha se ikën vitet e lavdisë,
se s'vlen më krahu
i Gjergj Elez Alisë?
Se s'qënkej fati
të bëheshim heronj si Vojua e Qemali?
Po ku ta lëmë këtë vrull rinie
këtë start vrapiimi drejt atij ideali?

Ndaj ushto ti, köngë djaloshare,
me aromë pishash dhe djerse!

Ti ke fatin tē jesh moshatare
e rinisë sē vitit gjashtëdhjetë e pesë.

Ti ke fatin tē jesh aksioniste.
Djersën... ar, o këngë, ktheje ti!
Ndjenj' e vjetër kjo pér ne, shqiptarët,
veçse gjaku rrjedh nē dej i ri.

Këtu janë pyjet tē paanë,
jugu im éshtë shumë më i butë.
Unë nē mendime bie prapë,
mendimet sikur burojnë nga drurët.
Mendimet janë tē ashpra, tē holla,
e kanë shtatin si pisha...
Herë digjen e bien nē trungjet e rrëzuar,
herë çelin tē gjelbra, tē lira!

Hej, ju, pyje, ju, pyje tē naanë!
Ju vërtiten si tespije shekujt,
ret' e ngarkuara
dhe armiqtë
mbi ju derdhën zjarrin dhe rrufetë...
Si faraonët pas vdekjes,
thesar donin t'ju merrnin me vete
por ju s'u zhdukët,
ndonse u xhveshët vende-vende,
si kafshët nga e flliqura
zgjebë!

Të tjera pisha ngriheshin lart,
si duar që u turreshin reve:
u kërkonin malet ndihmë prej krerëve.
Por bajraktarët

qenë tē pabesë si reja,
qenë tē dobët si reja,
që pas avazit tē saj ngado e vërtit era.

Duhej tē ngriheshin pishat akoma më përpjetë,
duhej pishat t'i kalonin retë.
Të kapnin lartësitë,
të zbrisnin në tokë,
qiellin e kaltër me yje tē zjarrtë,
lirinë!

Ne na ka Shqipëria
si lulet
që zbukurojnë dritaret!
Shoqe, moj,
ju jeni rruspa ujrash!
Shoqe, moj,
ju jeni shtojzovalle!

Ju nuk dollët tē na merrnit meudjen
dhe tē zinit thellësitë sërish.
Uleni ju hijshëm buzë Fanit
dhe lani me shokët këmishët.
Nga balli njëlljo ju rrjedh djersa:
tok në punë, tok këng' e valle.

Ja pse janë shqiptarkat rruspa ujrash,
ja pse janë shqiptarkat shtojzovalle ! . .

Ne erdhëm në malësi,
por jo pelegrinë,
se, kush kërkon këtu qetësi,
i hedh zemrës edhe më shqetsim.
Një qëllim i madh na mban tē nderë.

Muskujt me shkëmbijtë do t'i matim,
që këtej komunizmit dorën
ballëhapur do t'ja zgjatim.

— Toke komunizëm!
S'jemi heronjtë e lashtë,
që gjenin lëkurën e artë.
Ne duam qyrkun e gjelbër
t'ja hedhim dhe shpinës së malit.

Do matemi me pishat vigane,
do matemi me parzmet e gurta të maleve!
Dhe pishat do t'i zbutim,
dhe malet do t'i shtrojmë,
shekulli modern
në këtë vend epik
si ne, në bulevard, do kalojë.

Hëna si kunadhe lart është ngjitur
dhe përgjon e qetë yjt' e zjarrtë.
Pse i dehur ndjehem sot në deje
pse jam i shqetsuar këtë natë?!

Po!
Ushto ti, këngë djaloshare,
mblidh
aroma edhe bul a djerse!
Ti ke fatin të jesh aksioniste,
ti ke fatin të jesh këngë jete!

Dua, o këngë, të jesh e stuhishme,
të mos tretesh kurrë në harresë,
por të thonë:
Ja një këngë
moshatare e vitit gjashtëdhjetë e pesë ! ..

KËNGË PËR PRINDIN E MËSUESIN

XHEVAHIR SPAHIU

KËNGË DASHURIE PËR BABANË

I

Kjo këngë, baba, për ty është e gjitha,
edhe fill ka zënë që kur unë linda.

2

Një mëngjez të kaltër u ktheve nga malet,
një botë me yje përmbi supe mbaje:
kisha lindur unë,

fëmija e parë.

Ti ahene qeshe, at' i lumtur, qeshe

— Ja, — the, — liria,

ja edhe një djalë!

— Piip, — hundën ma shkele,

mbi yjet e kuq

kokën ma mbështete.

Dhe më pas më fole fije e për pe:

E rrëmbeve pushkën
që krenar e plot gaz të thosha unë:
«Babi im ka ngrënë barutin me grushte,
doli nëpër male, se njerëzve u duheshin
simfoni bilbilash e jo kuje qyqesh,
shumëzime yjesh, jo karvane kryqesh.»
Dhe sa herë plumbat ty ta taksën jetën!
Po plumbi është jetë kur lufton për jetën.
Dhe më fole, at', fije e për pe:
«Ne kjo luftë e shenjtë na nxori në dritë.
Ishte kaq e ashpër, kaqë e fortë,
sa mbërtheu diellin në qiellin e kaltër
të ndrijë për ne!»

II

1

Kishte ardhur koha për një luftë të re,
ti në mur atëhere vare bajonetën,
CAPE një pushkë tjetër,
maleve iu turre që t'u çaje gjoksin
drejt me pistoletën.

2

Pati nga ata që s'besuan e qeshën
nga ata q'u tallën
dhe dhëmbët ngërdheshën:

«Si mund të ndërtohet socializmi vallë?!
Pa këpucë
Pa kulturë?!

Dhe bile... pa bukë?!»
Por ja që u ndërtuaka dhe kështu,
duke ngrënë
misër edhe qepë.

Kjo ndodh
vetëm kur rrugën çan si ne,
me gjoks,
me bajonetë.

3

Dhe u nise ti
t'u zbërtheje brinjët malevë, baba!

Se duhej që buka të ishte e grunjtë,
bluza, pantallonat duheshin të reja,
që fëmijve mollzat t'u kuqonin gjak,
sepse libra donin «të pagdhendurit»,
Duhej me librin të flitej pa tjetër,
në bebe të syrit ta shikoje jetën.
duheshin pa tjetër ...

4

Unë të sillja bukën,
shpesh flisja me vete:
«Këtë bukë misri
as babai s'e shpon,
sikur ta godasë me pistoletë!»
Dhe habitesha

kur tromákste malin
kollë e bardhë e minës,
me të fortat duar, si vare e rëndë,
shkëmbin shkoqje ti,
ndërsa retë shkoqnin:
borë,
breshër,
shi.

5

Kur rëndonte dielli
si një saç mbi kokë,
ujë sillja unë pér buzët e thara,
shihja kur nga djersa
të shkëlqenin muskujt
si çelik i skuqur,
kur me sup shtrënguje, ngjeshje pistoletën,
që ta dridhte trupin si rrymë elektrike;
pluhuri i gurve t'i bënte të bardhë:
flokët,
kominoshet,
opingat llastike.
Si një gjigand mali
tundte krahët pisha,
çudia m'i shtangte kapakët e syve,
kaqë i vogël isha.

6

Drejt në gjoks me grusht malit ti i re,
ari i mushkërive duhej të zbrazej

Grushtet e tú zgavruan si deje galeritë,
si deje ku lëvrinini, në vend të gjakut, njerëz,
njerëz dhe vagona,
vagona edhe njerëz.

Flakë e fitilave,
vrapo minandezës.

Prej buçitjes së minave
përpëlitet mali.

Trurin krejt ta mpinte
dinamiti i zi,
sikur të kishe rrëkellyer
një okë raki

7

Dhe niseshin vagonat,
máqinat radhë-radhë,
mbushur buzë pér buzë
nëpér rrugën e madhe.

8

Pa dalë dielli shkoje
dhe ktheheshe në muzg,
me pistoletë lodhjen
e mbërtheje në gurë.

9

Kur nga puna vije,
unë kërceja pupthi,

djersa shpejt të hiqeji,
si pluhur nga supi.

10

Me Bajon çdo mbrëmje
gazetën çfletonit,
tok rrihnit probleme,
jetën e shpjegonit,
nëpër dhëmbë shanit:
«Ende maskarenjtë vrasin në Kore!»
«Ende krimbat ngucen vërave tek ne!»
Bashkë kthenit gotat
me raki të fortë
dhe ja merrnit vénce
asaj këngës sate, që e doje shumë;
(unë hapja sytë, syt' e mi përgjumë)
«Internacionale do jet' bota e re ! . . .»

11

Një natë nuk më përkëdhele fare...
Ajo ditë Bajon kishte vrarë
atë ditë minat Baion kishin marrë,
dhe s'hëngre, as fjete.
Lotët çurg për shokun
derdhe ti në heshtje.

12

Me librat në gji,
zbathur, në këmishë, pantallona-shkurtër.

rendja për në shkollë.

Një mëngjëz, i trembur qëndrova në prak,
s'doja që të shkoja,
qielli thyente shtëmbat

në shkëmbinjt' e reve.

Ti më rrahe, atë,

se duhej çarë mespërmes stuhisë.

Dhe kuptova unë:

«Duhen çarë shtigje,

u dashka pa tjetër, t'i mësosh njerëzit

te dalin ne brigje».

13

Shpesh me nënënen haeshe,
sepse dhe shtëpia kishte halle shumë,
sepse, që të rritet, do kujdes çdo bisk.
Dhëmbët i ckërmiste

mbas shpine armiku,

dhe buka ahere

ende qe me triskë.

14

Por prapë ne përpara ecëm,

drejt.

Kjo ndodhi sepse rrugën ne

e çamë me bajonetë.

15

Thellë e më thellë ti iu fute malit
edhe ja, baba, rrodhën kaqë vjet,
rrodhën kaqë shpejt!

III

1

Në luftë me malet do të të mendoj
dhe jo në shullë, duke shkoqur gjerdanin me
tespije
por duke vërtitur
male,
globe,
yje.

2

Malli më ka marrë,
ndaj të erdha sot,
dhe ky kthim m'i solli gjithë këto kujtime
si një gur që sjell dhjetra rrathë mbi ujë.
Shtrëngoma njëherë fort ti këtë dorë,
me atë të ngrohtën,
të djersitürën,
të dashurën,
tënden dorë
Puthëm, pra, i shtrenjtë, siç di ti: në ballë,
që kështu, baba, të më nxjerrësh mallë.

3

Tungjatjeta, baba!
Ti tani po vjen drejt nga zemr' e malit,
nga universiteti kthehem unë, djali;
tok t'ja marrim vënçe, ashtu si dikur.
Iso, vëllezër, bashkohuni me ne!
«Internacionale do jet' botë e re!»

MESUESES SE KLASES SE PARÉ

Pse më shikon kështu, menduar,
shënime s'mban në seminar,
nuk t'kujtohem, vallë, s'më njeh mua?
Jam nxënësja jote e klasës s'parë.

Jo, jo, për ty nuk jam e huaj.
E kujton sa herë më qortoje,
se isha unë pakëz «çapkëne»
dhe bojën e derdhja mbi fletore?

Në sytë e tu shkëlqen gjëzimi,
që fruti i punës t'ka dhuruar,
dhe ndjen se s'shkoi kot mundimi,
kur më sheh sot mësuese të dalluar.

Të shoh me dashuri sot unë,
dëgjoj atë zërin që më ngrohte.
Oh, si në fëmimi dikur
unë mbetem përsëri nxënësja jote!

E DASHUR NËNË!

Të shkruaj, nën', nga larg. Si ja çon
me punë e me shëndet? Se kam mall.
Diçka punon pa tjetër sonte vonë
e pyet si shkon jot bijë tani, vall'.

E di që s'vuan dhe pse larg më ke,
veç më kujton pérher' prej dashurisë.
Të gjithë bashkë punojmë në trase,
me gaz ja marrim këngës së rinisë.

Këtu një shoqe njoha, e thonë Zanë.
— Jetime jam dhe un' si ti, — tha.
Dikur iu vra babai në barikadë...
Ndoshta... bashk' me atin tim ai ra...

Tjetër ç'të them ?... Dje ja ç'më ndodhi:
një gazetar na erdh në kompani
e në «syrret» (si thua ti) më nxori.
Të lutem, gjej' gazetën e më shih !...

JU. BABALLARET TANE

MESUESI

Këndohen këngë nëpër botë,
 po jo çdo këngë vjen deri tek ne.
 Kënga e mësuesit marshon me brezat
 e gjithmonë ngelet e re.

KUNDRA BESTYTNIVE FETARE

Första att komma till landet
och därmed mäktigaste var den kung
som i guld och silver rymde
och därför han kallades

den gula kungen. Men
därmed kom dock förturerna
och vrede och krig och förlust
och därför har man kallat honom

NË KISHË

Në të nuk hyra mbushur përdëllim,
përulur si fanatik, besimtar,
kumban' e saj me t'egrin tingëllim
s'më tha: «Bëj kryq, njeri, o mëkatar».

Fraza latine, veshur veladon,
s'kishte mbushur sallën me ftohtesi,
zëri i priftit, çjerrës, monoton
s'i ndolli shpirtit tim melankoli.

Kur hyra, kori besimtar s'kuiste,
shenjtorë, ikona s'pashë nëpër mure,
këng'e rinisë vrullshëm seç buciste.
Ej, kisha qenka bër' vatër kulture!

KOHA DHE FEJA

Robëtime,
 lutje,
 vuajtje, lypesa,
 errësire. Kënaqësi,
 Kënaqësi për ata, «Vëllezërit e zotit».
 Minare, tyrbë, kisha:
 per «Shërbëtorët e zotit»
 të tilla skena pe,
 o tokë
 në shekuj.
 Do ta shohësh,
 o tokë,
 këtë tablo
 këtë radhë,
 të vdekur.
 Boll rrojti kjo plakë,
 kjo shtrigë
 e ndyrë,
 që mesjeta e polli.
 Fëlliqësi e lashtësisë,
 llumi.

PËR REPUBLIKËN

A të kujtohet kur linda,
Republikë?

Tymi i luftës ende s'ish larguar;
era e barutit ende vazhdonte,
drurët e çative, urat varur,
qytete e fshatra të tëra rrënuar.
... Por liria kish ardhur,
dhe me vete,
të solli ty,

Republikë!

Një ditë atdheu ishte në festë,
nga gjoksi i shqiptarit shpërtheu gëzimi:
brohoret i vogli,

i madhi,

brohoret fshatari,

brohoret qytetari —

ishte 11 Janari.

Ishte ajo ditë

plot thirrje:

Republikë!

Popullorja

Republikë!

Ajo ditë,
kur u kalite në kufitë
ti Republikë
Eh, si u tërbuani armiqjtë!
Veten e hëngrën me dhëmbë
Të çmendur plane hartuan;
me mijëra herë u betuan...
Por ti madhështore marshoje;
pa frikë
erdhi koha:
Mjaft!

Mjaft!

Mjaft!

Pushoi së enduri
pëlhora e fëlliçur e merimangës,
i shkulëm thumbat prej trupit
i thyem gotat e helmit.
Dhe një kryq po të vëmë,
Kryq të pregatitur.
jo në kohën e Jezu Krishtit,
se «Zoti ja fali vetëm priftit»,
po të pregatitur
nën llambat e neonit,
nga ne,
pjestarët e Revolucionit.
Ne që themi «Prejardhjen e kemi prej
ne sot po të shkulim dhëbin e fundit.

COU « I LUMI KRISHT »

E hapëm portën e hekurt,
të ndryshkur,
të vjetër.
Nga frika përpjetë u hodhën,
Krishti,
apostujt.
N'altarin e shenjtë,
të nxirë nga tymi i qirinjve
(sa derra aty kanë shkrirë),
ne vumë një llambë të fortë,
100 volt,
si yll në errësirë.
Te porta,
plaka të kërrusura.
luteshin,
trembeshin,
mallkonin:

«Mëkat!
I lumi Krisht.
çfarë duan këta malukatë?
Na prishën altarin e Zojës,
T'lumes q'i falemi për natë!

Mékatë!»

E duart lëvizin prej frike.

C'po ndodh?

Diçka enigmatike.

u pre rruga e përditëshme.

Një tjetër plakë flet:

«U prish!

C'e duam? ~~IMJUJ N UQQ~~

Ne gjakun e djemve s'kursyem,

E jo një kishë».

Po, nënë!

Ne kishën palestër do ta bëjmë.

S'ka gjë se «I lumi Krisht»

mbi supe kryqin prapë do vëjë,

e do niset,

për ku, kush' e di?

E buzët do ndrydhë

me neveri.

E ndoshta Jehovaj,

me zërin e tij,

qiejt do çajë:

— Të qofshim falë, o Zot!

C'po bëhet kështu sot? —

Po zëri i tij

do humbasë

në zhurmën e traktorit,

që maleve kullot.

E zoti do trembet,

do shohë vete e tij:

A është më Zot,

apo u bë njeri?

O «I madhi zot»!
Ne s'jemi burokratë,
nga froni i lartë
të japim veç urdhëra dit' e natë.

Dhe ti, «I lumi Krisht»,
ke shekuj që je bërë i brishtë;
mbi supin tënd delikat
hidh kazëm e lopatë.

Përpara shokë!
T'u qepemi maleve,
t'i bëjmë taraca;
të ngjitemi gjer te retë...

E zotin ta zgjojmë nga gjumi,
t'i themi: «Çou, se të mori lumi!»

NDREKE GJERGJI

TRI DYER

Për fshat u nisëm
nën qielin me re arnue:
Udhëtojmë...

E, sa për rrugën,
Vjeshta fjalën ka,
kurse na
zemrën pranverë.
Herë-herë
idhnohet ndonjë re
e me tûrr
barrën e saj të lagësht
lëshon mbi ne.

Ecim.
Batanijet krahaqafë
kemi varë.
Kemi kohë me i zgjidhë,
shkojmë vullnetarë.

Thanë:
— Vullnetarë të rij,
do të flini
në shkollë.

kishë
e xhami!

Ndër tri institucionet
fjetëm ne:
në shkollë,
ku filizat e ri
Vaditen
e rriten
për nanën Shqipni.
Në kishë,
në xhami,
ku, veç prifti e hoxha,
edhe ndonjë plak a plakë
për lutje
në gjunj përule
me shejtni.
Derën e shkollës mësuesi është çeli,
me nxanës na priti buzagaz.
Derën e kishës,
derën e xhamisë
me levë i shpërtheu
sekretari i rinisë,
e nga unë,
nësa prakun e derës hedh,
një plak
vetullat çapraz i mbledh
e shikimin e vengërt s'ma heq.
«Hej, plak fanatic!»
Vërtet' sot hynam 'xhami,
por unë s'jam drëq.
Njimend
koka jote si bashkë e bardhë

për mue asht thesar,
por...
kurani anadollak
tek ti ka mardhë
mendimin e pastër,
mendimin
me vlerën ar.
Dhe djali i plakut qeshi,
qeshi
kur babën pa,
Po. Djali qeshi,
sot,
në klasën e tetë,
ai mëson tjetër gjaja...
E ja, tashti po m'ndihmon
rrrobet brendë me i shtie.
E vetë them:
— Këtu
fuqia e plakut bie!

O e akullta xhami,
në këtë dhë
farën tandem mbolli
i ndyti
anadolli!
Sonte nuk fle,
gjumi s'më ze
e mendja ban rrugë
Nëpër shi.
Te shokët e mi,
që, me bujtë,
në kishë kanë hy.

KISHA E RUBIKUT

Dikur,
të dielave në mëngjez,
si dhitë ngjiteshin shkëmbit varg
njerëzia.
Prej majës së shkëmbit, nga larg,
kumbonte mistershëm
«Ave Maria».

Ushtojnë në këtë mbrëmje kambanat.
«Ç'ka ndodhur?» çuditen e pyesin pleqtë.
Në kambanore një flamur rreh palat.
«Ua, na kanë vajtur në kishë djemtë!»

Sonte s'bie zilja
për fillimin e meshës,
qirinjtë s'ty whole sin altareve,
Shën Marisë ja zuri vendin
«Cuca e maleve».

TĒ N D R Y S H M E

SKËNDERBEU

(Këngë labçe)

Ç'u bë Skënderbeu ynë,
ushtën ku e la?
U këput si lis i rëndë.
porsi lisi ra,
u bë mjergull, që armiqtë
udhës t'i verbojë,
u bë lumë i rrëmbyer,
vrapin t'u pengojë.

U bë këngë popullore,
rrjedh si gurrë mali,
zë e flet nga çiftelia
si dikur nga kali.
Pastaj ngrihet sipër gérxhës,
sulet ajo këngë,
mbi armiqt e këtij trolli
bije porsi shkëmb.

Ç'u bë Skënderbeu ynë?
Thonë u bë erë,
kur shikon nga larg armikun,

vërshëllen pa prerë.
Zë thërret në gjithë vendin
Vet' shkon në kufi
Bëhet mal me shtatë kreshta
Ai trup i tij.

Ç'u bë Skënderbeu ynë,
shpatën ku e la?
Kal' i bardhë jele-gjatë
përmbi varr ç'i ra,
mbinë këngët edhe lulet,
manushaqe, mendra,
përmbi varr një pyll i dendur,
pylli me legjenda.

MENDIME PRANË STANIT

Udhëton kjo natë vere pranë stanit tim
dhe unë,
çlodh e ngatërroj trutë e përgjumur
me numurime yjesht të panumurt.

I lëshova padashur
mendimet e mia të bardha,
mbi lesh të butë qengjash që flejnë.

Në shtrungë po gérhasin dhentë,
qentë ndër monopate se çfarë kanë . . .

Mbetet ritmike frysma e qengjave;
yjet këputen qiejve paanë.

Po krihen delet nga drita e magjishme,
mes ëndrrash të çudiçme.

Ëndrra naivë bagëtish,
që trëmben papritmas,
nga lehje qenësh monopatave të largëta

I përzura mendimet,
për t'i marrë akoma kësaj nate labe
edhe një sy gjumë gjer n'agim,
nën këtë çarçaf të ndritur yjesh,
pran' stanit tim,
këtu... ku bie erë cëfakash e tërfili.

Natë labe,
me një culë të vonuar, që ligjëron me derte
ledheve ku bariu gjumin vret me këngë
tek kullot kopenë,
ndërsa mendja i ve të
atje... n'ata lugje ku vajza ka nomenë.

Natë labe,
me zë laureshe që pushon përmbi gurë,
me këngë bilbili që nuk mbaron kurë,
ah, këngë, po... c'këngë bilbili !...
të ndërprera rrallë,
prej isos monotone e të largët të qyqes,
që aq magjepëse
e bën këtë natë të bukur prilli.

Natë labe,
më uturima ujqërish honeve të thella,
plagosur nga sokëllima çobenësh të pagjumë;
me hingëllima mëzash harrakatë,
që, nën dritën e hënës,
kan' parë aq pak e kan' bredhur aq shumë.

Natë labe,
me mendime bujqërish për punët e nesërme,
me biseda të çudiçme turtujsh ndër korie,
me qetësi krojesh,

dhe me shqetësimin tim për aftësinë e vjershavë
të të shtojnë ty,
goft' dhe një grimcë përjetësie!

Natë labe,
qëndisur me yje shaminë e kokës
dhe mbushur prehërin me qëngja të bardhë.
O, netë, ju netët labe,
që përjetësisht
u dogjët ndër agimet e trëndafilita!

O stane,
ju, o stane lebërish,
që s'u këmbejmë
as me vilat buzë deteve të kaltër!

Tek ju,
tek ju gjeta prehjen, frysëzimin,
dhe vdekjen
pranë jush e lakmoj,
atje, mbi atë ledhin,
ku ësht' një gur i bardhë
dhe lule mali mbijnë çfardolloj.

Po sonte,
unë mendoj për jetën,
edhe më ngjan
se yjet që këputen qiejve paanë,
të ndezur jan' e të zhuritur
për ujë nga gurrat e Labërisë sonë.

Ndaj ulen ata poshtë.
dhe, pasi shuajn' etjen,
digjen

mbi kokat e trimave që prehen përgjithmonë,
në gjin' e kësaj balte të ëmbël e të shenjtë!

I përzura mendimet pa numur,
që më ngatërrojnë trutë e përgjumur.
Vetëm një mendim nuk e mërgova dot kurrë,
ai, vetëm ai
m'i mbylli ngrohtësisht qepallat e lodhura,
qysh nga çasti fatlum,
kur gjyshes që po ndillte pulat,
të parën bejte i këndova unë.

Ai mendim i kthjellët
u madhërua më pas mbi vitet e blerta,
duke zbehur pa kuptuar
ëndrrat e mia, pasionet, dashuritë,
gjithçka që kam krijuar.

Ah, sikur ta dija:
a do të mundem një ditë

KRENARINË QË LINDA NË KËTË TRUALL,
në vargjet e mi
ta skalit?!

KUJTIME

Buzëqeshin prapë trëndafilat,
bliri shpërndan aromën larg,
dikur unë mbrëmjeve të tilla
dilja në fëmijëri, në prag.

Dhe rrugëvet të katundit shkisja
mes qetësisë edhe blerimit,
me vete, si lutje, përsërisja
të émblat vargje të Naimit.

Pastaj pyll'i vogël kaltërosh
hapat e mi ritmikë dëgjonte.
Në qìell hëna krekosej si kokosh
dhe rrezet si këng' gëzimi lëshonte.

Un' ecja i heshtur dhe në kokë
mijra ëndrra më vlonin pa pushim,
që ahere ndjeva: këtë tokë
si i çmëndur do ta dua në amshim.

Ndaj jam gati në dhjetra beteja
të sulem sypatrëmbur për të,
që ditët e lumtura, të reja,
të vinë pa i lënë mangut asgjë.

TOPI I MUZEUMIT

Në muzeum të luftës, në oborr,
ku ndrin mes pishash një copë qancell,
një top i gjelbër, madhështor,
gjymtyrët ngroh i lumtur në diell.

Dikur ai u sul trimërisht
në beteja armiqt' duke thyer,
Tani prehet si pensionist
me ndjenjën e detyrës së kryer.

Dhe shekujt para tij kokën lehtë
do t'ulin gjith' respekt e nderim,
sepse nuk vdes ai që, në jetë,
rrugën e çan kështu si ky trim ...

MOSHATARËT

Moshatar,

vërsnik i çlirimit,
për ty po e mpreh vargun tim.
Janë këngë, shtigje dhe shpate.
Ty t'i blatoj,
andaj pranoi si dorështrëngim.

Moshatar,
fëminia iku, ne rrugën nismë
me këngë e libër në uzinën e re
që atdheut t'ja shtojmë štolitë,
që të krenohen brezat me ne.

Moshatar,
o vërsnik i çlirimit!
Dëshira ime është e pafund.
Në brezin e blertë, ku ti bën roje,
dua të mbroj atdheun nga çdo furtunë.

S O N T E

Dy shokëve studentë kinezë

Sonte vonë mbeta zgjuar,
hëna është ulur në dritaren time,
shokët e mi po enden kaluar
në flatra ëndrrash, përtej oqeanesh,
atje, ku ndërthuren mijra vezullime.

Endet sonte shoku im nëpër rrugët e Shangait,
ndoshta diku mrekullinë e parqeve sodit,
ndoshta gjendet mes teracave të Daçait,
a i inkuadruar në rreshtat e kuq, gardist.

Tjetri në fushat e orizit gjendet këtë mëngjez,
a frymëzohet nga perëndimi në malet e kaltra,
rreth vatrës me komunarët bisedon miqësisht...
ndoshta po shkrin çelik në furrat e zjarrta.

Vështroj hënën, dhe shokët e mi, që bredhin
larg, ku furrënalat janë shtruar në bisedë me diellin.

NATË VIETNAMEZE

Natë vietnameze,
Saigoni fle e s'fle,
qyteti ka ethe, mërdhin...
Pranvera shëtit e trishtuar
bulevardeve të përgjakur.

Prozhektoret
si thikë
u ngulën hijeve të natës,
brigjeve,
pyjeve,
monopateve...
Po ku mund të gjendet liria partizane?!
Ajo është kudo:

në një bombë të fshehur në gji,
në ninullën e nënave të dashura,
në grushtet e hekurta të radhëve demostronjëse,
në zemrën e këtij populli uragan.

Tani ajo çlodhet maleve,
duke lidhur plagët e mara

gjatë sulmeve të reja të ditës,
duke pritur me këngën e s'ardhmes
mëngjezin të zbardhëllojë.

Gjeneralët, në Saigon, përkulur mbi harta,
projektojnë bombardimet e së nesërmes,
mitralimet e reja të zonave të çliruara,

pa e ditur
se kështu projektojnë përfundimisht
katakombet e tyre!
Dhe grykat e topave,

si gojë të zeza vdekjeje,
përpiqen të kafshojnë copra qielli blu,
përpiqen të kafshojnë lirinë partizane, maleve,
diku.

Por janë të vegjël,
tepër të vegjël kalibret e topave
për të zënë qiellin e yjëzuar.
Më dëgjoni, janki?

Janë tepër të vegjël kalibret e topave tuaj
për të zënë qiellin e yjëzuar.
Kurse këto miliona yje, që ju rrinë mbi krye,
janë milionat e tytave të pushkëve
të këtij populli hakmarrës pér bijt' e tij të rënë,
që do të derdhin plumb mbi kokat tuaja!

* * *

Natë vietnameze...
Ndonse është akoma natë,
diku, në largësi, kuqëlon horizonti,
duke shpërndarë nga jugu mijra rreze,
duke përshtendetur lirinë vietnameze.

BETIM MUÇO

VARGJE PËR HEROIN VIETNAMEZ

Me ç'lajm të zi agimi sot na zgjoi
e plumb të rëndë lotin lëshoi syri,
djaloshi vietnamez, Ngujen Van Troi,
komet' e zjarrt' në mendjen tonë hyri.

Ndaj sonte gjithë ëndrrat i dëboj,
vështrim' i tij aspak s'më lë të qetë,
atë porsi të gjallë e shikoj,
kur përmes plumbash kokën ngre përpjetë.

Ai nuk donte kurrë që një popull
të ishte kudhër e dikush çekan,
dhe ëndërronte, ndoshta, që orizi
i lart' të rritej fushës në Vietnam.

Dhe s'kishte cilësi të jashtzakonshme,
Dhe as shkëmbinj, si Herkul, s'kishte shembur,
por kishte zotësinë më të madhe:
dinte të vdiste, vdekjes pa iu trembur.

Ta kam zili guximin tënd. Ngujen!
në sy e pe ti vdekjen, si luan

lavdia e mbuloi emrin tënd,
si bora e përjetshme Himalanë

Për ty i thura këto vargje, pra,
ndaj sonte gjithë ëndrrat i dëbova,
ndaj përmbi emrin tënd, Ngujen, vëlla,
për luftë dhe hakmarrje u betova.

Se ne s'e duam botën të coptuar,
Çdo pikë gjaku zemrës na pikon.
Ndaj, kur Vietnamin janki ka sulmuar,
Ne ngrehim zërin edhe grushtin tonë.

PËR RININË TIME

Shpërtheu prej kantieresh,
shpërtheu prej ugaresh,
edhe tek unë erdhi rinia.
Me muskujt e çeliktë
dhe flakë idealesh
saldova me guxim ëndrrat e mia.

Në zjarrin e furishëm
të jetës madhështore,
një ur' e ndezur dua që të jem,
në murin e fuqishëm
të gjokseve puntore,
në vij' të sulmit vendin ta kem.

Për komunizmin, shokë,
kashtën e Kumtrit do luajm' vendit ne,
dhe yjet si pishtarë
do t'i mbartim mbi shpinë,
që të ndriçojmë botën e re.

Kur dielli i komunizmit
do ndrisë përmbi tokë,
do jetë kjo m'e madhja lumturi,

at'her do jemi shumë,
me qindmilionë, shokë,
do përshëndesim këtë diell të ri.

Shpërtheu prej kantieresh,
shpërtheu prej ugaresh,
edhe tek unë erdhi rinia.
Me muskujt e çeliktë
dhe flakë idealesh
saldova me guxim ëndrrat e mia.

ZHULJANA G. JORGANXHI

ENDRRA TË PAVDEKSHME

O ëndrra komuniste, të guximshme
ëndrra!
Sa herë ju ngrohu zjarri partizan,
kur çakejtë përpinqeshin me thundëra
të rënda
t'ju shtypnin,
t'ju mbytnin
në gjak e në gjamë.
Dikush kujtoi se varur ju la
aty, në trikëmbësh a në grykën e
pushkës,
por prapë kokën ngritët lart
dhe dhatë përsëri kushtrimin e
luftës.
O ëndrra komuniste,
të pavdekëshme ëndrra!
Nëndori ju lindi binjake me partinë,
juve gjak ju dhuruan me mijra zemra,
në mal,
në qytet,
kur kërkonim lirinë.
O ëndrra të lira,

MALESORI I «LEGJENDËS SË MISRIT»

Malësori i «legjendës së misrit» dolli
një ditë që nga kënd i muzeumit,
nga thes i grisur kujtimet i cimbështollit,
të merrte udhën e dashur të katundit.

I ra përmes një rruge dhe një sheshi
që shpinte nga «pazar i vjetër»,
polici në trafik e pa... dhe buzëqeshi
me t'ardhurin prej një epoke tjeter.

Mbërthyer nga reklamat dhe vitrinat,
ai qëndroi pérpara një teatri.
Në hyrje desh t'i zbathte opingat,
siç bënte në xhamin' e fshatit.

Kur pa një bajraktar musteqevarur
ta sillnin duarlidhur në skenë,
— Ma lini mua, — thirri që nga salla, —
Ma lini që ta rjep të gjallë, qenë!

Nga çfaqja shkoi me mëngë të përveshura
dhe an' e kënd kërkoi «pazar' e vjetër»,

dhe e kuptoi nga fjalët e padëgjuara
që vinte prej nj' epoke tjetër.

Atij, që prej legjendave kish dalë,
që emri iu ronit mbi rrrokjet mi-sër,
përkthenjës do t'i duhej sot pér fjalët
revolucion, furernalta, komunizëm.

ERA E TOKËS

Erdhëm dhe i përbaltëm fjalët
me baltën e tokës alpine,
erdhëm dhe i lagëm ballët
me dwersë ndër punime.

Dhe e futëm dorën thellë
në gjirin e tokës së bruztë,
ndenjëm si bujku në diell,
e rreshkëm lëkurën e butë.

Dielli na binte supeve
e rrugës shkonim nëpër pluhura,
e arave kalonim mes gjembave,
veç arave ndiqnim dhe flutura.

Kur shkrepte zjarr i xixillonjës
dhe ëmbël flinin fshatrat,
ne thithnim erën e tokës,
ne thithnim mbrëmjet e kaltëra.

NE RRUGËT E MIRDITËS

1

Dikur
gërxheve të Mirditës
yje u dukën...
lindën horizonteve yje udhërrëfenjës,
yje udhërrëfenjës lindën dhe
Mirditës.

Bajraktarët,
duke tundur pushkët e arta,
u munduan
me fasha mjegullash e resh
dhe pelerina nate
t'i zinin sytë Mirditës,
humnerave të reja ta shtynin
Mirditën.

Nga yjet
Mirditën
me fashat e reve të përgjakura
donin ta ndanin! .
Nga yjet,
në fashat e reve të përgjakura,

lindën vetëtimat dhe furtunat,
dhe vetëtimat
dogjën bajraqét,
dhe shtërgatat e kuqe
honeve të botës përplasën bajraktarët,
dhe yjet që u dukën
që u dukën horizonteve dhe gërxheve,
mes krismave të armëve,
Mirditës i vunë kurorën e dafinës,
Mirditës i vunë kurorën e lirisë!

2

Thonë:

dorën qiellit po t'i zgjatish,
fronin ku rri zoti do të prekësh
kur je në malet e Mirditës.

Ecà nëpër malet e Mirditës
jo për të prekur fronin e zotit,
as për të parë
si mbrëmjeve hijet sulen lartësive,
apo si i tendos gishtat dielli,
duke kërkuar të fshehtat hijeve
 të honeve dhe pyjeve!

Eca nëpër malet e Mirditës
për të parë
si tërhiqet heshtja shekullore
 bjeshkëve,
si vërshojnë gjëmimet e motorëve,
si buzëqesh djersa në ballin e punës.
Në Mirditë erdha
të dëgjoj si brohoretjeta!

MBI TY, VAU I DEJËS

Sondat metalike dejt e malit brejnë,
dhe vala e Drinit hidhet si shkërbë,
sondat si duer mjeku bazamentin gjejnë
për veprën e rë.

Kazma qet xixa ndër shkëmbenj shekullorë
dhe sikur thërret: — Energji elekrike! —
Puntori me Drinin sot kangën ujdis
kangën epike.

Vau-Dejës! Minat përcjellin shkambinj ndër hone
dhe kang' e punës t'lajmëron mëngjezin,
mbi ty, Vau-Dejës, do t'ndrisin neone,
se minat zavendsuen këndezin.

NE QYTETIN E STUDENTËVE

Natë.

Natyra dremit.

Qyteti ynë, shtrirë gjër' e gjatë,
rri zgjuar, leksionet lëçit

Konviktet notojnë nën qindra drita
në oqeanin e natës pakufi,
si dhjetra vaporë që i gjen dita
duke transportuar miliona ëndrra,
lumturi.

FLETË—RRUFETË

Fletë-rrufetë —
kanune të reja
të ditëve të reja.

Ashtu si traktet viteve plot zjarr
i hodhi ato revolucioni mes nesh;
porsi trufeja kur del prej resh,
u sulën si kushtrim i ri
nëpër truallin shqiptar.

Zérin e tyre
të ashpër,
të ciltër,

të singertë
e ndjej të rrahi me pulsin e atdheut,
të rrjedhi jetëdhënës në damarët e tij.

Fletë-rrufetë —
kanune të reja
të ditëve të reja.

Ato thërrasin që secili nga ne
ushtar shembullor
i revolucionit
të jetë.

V A R G J E Ç O B A N E

Kto vargje nuk lindën n'qytetet e reja,
kur erdha nga fshati për herë të parë,
por lindën në malet ku veronte kopeja,
ku cula lëvdonte heronjtë me të qarë.

E nisa jetën në rrugën malore,
i grisa opingat në gurët stërrall,
kalova dimret kasolle më kasolle
dhe vapën e verës nga stani në stan.

Një ditë e lashë fshatin, i hipë maqinës,
i mora me vete dhe vargjet çobane,
kaluam tre vjet në bregun e Vlorës,
dhe vargjet e mia lodruan ndër valë.

Në Shkodër një vit me vargjet studente
qëndruam pranë kalasë me muret légjendare,
u nisëm pastaj të qeshur pas flamurit
e dolëm sulmues në aksionin vullnetar.

Dhe sot, si e shihni ju, vargje të dashur,
na fton instituti «Mirëseardhët!» si gjithmonë,
të bëjmë regjistrimin, të marrim fletoret,
pastaj dhe ne, çobanët, të shkojmë n'auditor.

P O E M A

KËNGË PËR NJERIUN E RI

p o e m ē

Montatorit M. Hoxha

1

Unë isha i vogël
kur bota bëri armëpushimin e madh,
kur Shqipëria numuronte invalidët dhe të vrarët
në qoshet gjermadhe.

Ne s'kishim ç'të hanim,
se zjarri i kishte djegur të lashtat,
vetëm ca thërrime nga buka e vdekjes
në arat e fshatit kishin mbetur.
Dhe, ndonse në qiell filluan fluturimin pullumbat,
nga toka s'ishin shkular ende
plumbat.

Mezi iu shkëputa tim eti,
nga lotët e nënës, lotë më ranë.
Dhe hodha supit një shkop të gjatë,
dy qentë, gjer dolla tej fshatit, s'm'u ndanë.

Shkela në rrugën e kafshuar nga lufta,
dhe mora kodrës nëpër ahishte.
Që andej, më dukej shtëpia
e ngushtë,
kurse bota sa e gjerë,
sa e madhe ishte!

2

Oh, q'kohë ish atëhere!
Armiqtë na sulmonin,
shtyheshin njerëzit para dyqaneve bosh
dhe ngjanin qytetet me ato rreshta të gjata, si
vija,
me faqet e një libri të madh,
të shkruar nga uria.

E q'mund të bëjë një 15-vjeçar,
që i dalin brinjët si një gërdalli plak,
që në qytet s'ka shkelur asnjë herë,
që s'bën dy fjalë zap?

Një ditë me diell,
(si gjithë ato ditë)
u takova me sekretarin e partisë.
Duke tundur kokën,
mbushi një fletë të madhe me fjalë
dhe supin më rrahu me dorën e saktë:
«Ti jeton në kohë të mëdha,
nga ti pret shumë Shqipëria,
o djalë.»

Luftha i kishte gëlltitur urat
dhe shiritat e rrugëve i kish prerë në mes.

Rrugët janë si arteret:
po i preve,
atdheu shtrihet,
vdes.

U nisëm ne
arteret e atdheut për t'i qepur,
ndonse ish vështirë
të mbahej trupi me pakë bukë thekre.
Dhe, kur punonim nëpër atë ngricë,
ne s'kishim çizme,
prandaj nga ujët, fap, ashtu pa zor,
në këmbë na kafshonte reumatizma.

4

Kështu u enda si cigan...
në shtigje të reja e horizonte,
dhe mjergulla bojë hiri e armiqve
na ndiqte pas kudo e na qëllonte.

Ne ishim katër shokë.
Ariani më i madhi.
Ariani ish i ri
dhe, kur mbaroi lufta,
nuk ndenji asnje natë në shtëpi,
se Shqipëria vuante nga uria,
se Shqipëria dridhej nga të ftohtit
se në gërmadha flinte Shqipëria.

Një plumb
në zemrat tona hapi plagë plot,
kur sytë e kaltër të Arianit mbylli,
kur syve tanë hodhi prapë lot.
Oh, ç'dhimbje! .

Kur shtrëngonte dheun,
për botën e re mos vallë ëndërronte?
kur buzët mbante kyçur,
legjendën e stërlashtë mos kujtonte?..

Ne' e mbuluam një ditë me diell,
me rrapëllimë ranë betimet tonë,
bashkë me dheun e thatë mbi varr,
dhe një tuffë lulesh të freskëta,
të njoma.

II

1

Aty u rrita unë,
në punë.

Atdheu merrte frymë lirisht
dhe po shpërndante mjergullën bojë hiri,
më të ashprit gishta.
çfletonte horizontet mbrëmjeve,
çfletonte abetaren netëve
dhe lodhej nga bashkimi i rrokjeve.

2

— U plaka, bir, kjo koka, shih, m'u zbardh
dhe fati motrat' larg t'i nisi, larg.
Neve, atje tej, ja, na u shemb një gardh
dhe punët rrijnë varg.
Gjithë vitin ti dy a tri herë vjen
dhe ditët po i ngrysim në vetmi.
Kjo pleqëri sa shumë po na bren
plot halle e mërzi!

U rrite, bir, po; për martesën tënde,
a ke menduar vallë ndonjëherë?
Ka çupa si lulkuqi te ky vend.
Trokit në ndonjë derë.

Vajzën e fqinjit tonë e ke parë?
E mirë dhe e bukur sa tjetër s'ka,
dhe dje na ngushulloj shpirtin e vrarë,
kur erdhi e na pa.

Reforma na ka dhënë tokë boll
atje tek lumi, ku u vra yt gjysh,
dhe kau pret, lopa larushe polli.
A e vendose, qysh?

Pa eja, bir, mendo për neve pak,
të shoç sa mirë është tani këtu.
Shikoje çupën, gëzoje nënën plakë.
Pa eja, bir, këtu!

3

Kështu më shkruante nëna në një letër.
Po ku ta dinte nëna, ati im,
se tok me shokët biri ndër kantiere
ndërtonte Shqipërinë?

Vitet e murme shkuan,
në rrugë derdhej gazi si shi vere,
me erë djerse ajri u mbulua
dhe vendi me kantiere.

E ku s'më hodhën mua ato vite?
 Mbi këto duar, që duken kaq të vrazhda,
 kanë hipur shinat,
 pra, ka hipur treni
 me gjith' ato të mprehtat vërshëllima.
 Mbi këto duar
 punon hidrocentrali ynë i parë,
 u derdhën ujrat nga fushat e Maliqit
 që të prodhonin an' e mbanë panxhar.
 Mbi këto duar...

Dhe mund të pyesni:
 Në ato vite të ashpëra,
 kur na kapiste lodhja gjithë trupin,
 kur ende pushkën mbaja prapa shpine,
 a gjeta ndopak kohë
 të përkëdhelja vajzën ndënë shkurre,
 t'i ledhatoja flokët vajzës sime?

... Kjo ndodhi buzë lumi Mat,
 kur ngrnim digën.
 Ajo me shokët zbriti që nga fshati,
 ajo, si unë, prindërve u iku.

Në muzg, kur linim punën,
 kur njerëzit nëpër rrugët,
 si dritat e shtëpive rralloheshin,
 ne që të dy atje, në breg të lumi,
 na shihje kur plot mall qafoheshim.

Majlinda kominoshet m'i përkëdhelte
që erë vaji, graso, djerse binin,
pastaj mendohej, pastaj ja kristë
të qeshurit.

Dy yj në sytë e saj ujë pinin.

Dikush na pa ashtu dhe buzët rrudhi,
dikush iu lut rrufesë që të na vriste;
pat nga ata që çfrynnë dhe mallkuani,
kur sytë fanatizmi ua nxinte.
Po u mësuan me dashurinë tonë,
burrat e ashpër,
fanatikë.

Bota e mendimeve të vjetra
bëri një vend për dashurinë e re,

III

1

Shtrihesha i këputur netëve.
Nga dritarja e barakës shihja gjerdanin e yjve
dhe parullën e shkruar me fasha drite:
«Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!»
Ledhatoja me sy yjet dhe jetën,
përkëdhelja me sy parullën proletare
dhe pastaj shtrihesha në gjumë
në ëndërrat ngjyrë portokalle.

... Dhe shihja si, mbi sumbullat e djersës,
lindnin agimet dhe fabrikat.

Shkëlqente gruri prej shëndetit dhe vesës,
ndjeja erën e bukës së grynjëtë dhe të librave
që prisnin blerës prapa vitrinave.

Dhe shihja si kthehej djersa jonë
në oxhaqe, buzëqeshje, petale,
miniera, lodra fëmijësh,
si kthehej në hidrocentrale...

Kur zgjohesha, bashkë me èndrrat e portokallta
shkrihesha me mëngjezin e zhurmshëm puntor.
Eh, mëngjeze të mbushura
me vulle të zjarra!

Do më kujtoheni ashtu siç ishit,
me romantikën e atyre viteve,
kur ndjenim drojën e kandileve,
kur ndjenim miqësinë e shtyllave
që kishin zënë që të gjitha radhë
të merrnin dritë nga hidrocentrali

Kështu mendoja kur futesha mes valëve
të lumit dhe të punës,
ndërsa dallgët ma rrëqethnin trupin
dhe m'i rrethonin ndjenjat me bardhësinë e
shkumës.

Kështu mendoja kur çfaqej filmi
herë kokposhtë, herë në tavan,
kur niste nga fundi,
dhe në fund vihesh fillimi.

O kohë madhështore, që vure në lëvizje turbinat,
ndërsa stërkalat vinin rrotull si flutura,
e bukur qe gjithçka që linde ti,
të bucura qenë dhe dashuritë e drojtura!

Dhe dita aq e pritur erdhi...
 Mes «urrave!» të shumta të gëzimit
 shihja fëmijët e përkulur mbi fletoret,
 burrat e vrejtur me buzë të celur
 që lexonin gazetën mbrëmjeve,
 shihja nënët që qëronin fasulet mbas darke.
 O Shqipëri e dashur,
 a s'më thua,
 kaq shumë dritë ndonjëherë a pate?

U takova prapë me Majlindën
 kur tuli i tokës u përqaf nga mbrëmja,
 kur sipër hieroglifeve-yje
 si Iuleshqerre e madhe dolli hëna.

Majlinda rrinte ulur te një trung,
 e larë krejt në dush të yjeve;
 një kukuvajkë klithte tej, në muzg,
 dhe hëna lahej sipër valëve.

Unë do ikja gjetkë, diku gjetkë,
 kështu e ka zanati i montatorit:
 baret si gjeologet posht' e përpjetë
 skelë më skelë endet si vaporët.

A mund t'ja thosha atë natë Majlindës,
 a mund t'ja prisja gazin mu në mes,
 a i këputet teli mandolinës,
 kur duam ta dëgjojmë gjer në mëngjez?

Por zemr' e saj rrihte pranë meje,
por zemr' e saj rrihte si çekan,
në flokë kishte ca petale yjesh,
në buzë i kish mbirë një tulipan.

Puliste sytë. Çast i mrekullishëm,
më çfaqesh shpesh ti para sysh pareshtur,
aty ngadalë, aty i vetëtishëm,
aty me vrull, aty i zbetë, i heshtur!

Kaluan orë... Gënjehet vetja vallë?
Një grimë lumturi, të lumturon?
Një grimë gazi a i bën dot ballë
zemrës që rreh si deti kur gjëmon?

...I thashë që do ikja tjetërkund,
se edhe pak dhe lamtumirë,
i thashë se ajo me mua s'mund
të vinte atje larg. E kish vështirë.

I thash se në familje është ngrohtë,
se trupi i saj është delikat,
se duhet dorë burri, dorë e fortë,
si shufër ta kthejë lumin harrakat...

Unë pandehja se dinte veç të qeshte,
se dinte veç të puthte mbrëmjeve,
kur m'i mbështillte kokën edhe supet
me flokë, atje tej, pas shkurreve.

Unë pandehja... çast i mrekullishëm!
Ajo i shkundi flokët porsi re,
me tërsëllimë ranë yjet e magjishëm,
një, tulipan i brishtë ra përdhe.

Dhe në errësirë brofi porsi mjellmë,
me këngë e ndoqa pas nëpër luginë.
Në atë natë njeri tjetrin njohëm,
në atë natë njohëm lumturinë.

IV

1

Në apartamentin tim të ngrohtë,
vitet e mi nisën të trokasin,
shkoj dhe i marr përdore në portë
vitet që qafat e dobëta zgjasin.

2

Im at' shitet botën me radion e madhe,
që i duket si mëz pa fre dhe pa shalë.
Natën si fshehur,
me nënën përkrah
nisen të dy
në kinema,
Majlinda vë foshnjën në gjumë dhe qesh.
Macja e hirtë mustaqet përdredh.

3.

Mes shkëndijave të saldaturës
shoh fëmijërinë time të drobitur,

me dorë ja bëj vogëlushes këmbëzbathur,
që vrapon ashtu si dikur vrapoja.
Dhe duket sikur turret pas shkëndijave,
siç tursesha unë dikur pas xixëllonjave.

Të shoh fëmijni nga ky oxhak i lartë
Të shoh ashtu, të gërdollur prej urisë,
si rendje në ditët e majit,
kur iu hodhe në qafë partisë,
siç i hidhet fëmija babait.

4

Frym era, retë e sfungjerta shtrydhen,
si rrufepritës rri përmbi oxhak
unë, puntori, po mbroj tokën nënë.
Jam unë që e ndërtova kat e kat...

Dhe sulem tej, kantiere mbaj mbi shpinë,
dhe i vendos atje ku do atdheu,
të hekurt do ta bëjmë Shqipërinë,
të fortë, të pathyeshme, si Anteu.

Kështu m'u end rinia ndër kantiere,
si çadrat e gjeologëve:
jugë-veri,
dhe i them vetes netëve shpesh herë
ç'gjurma gjigante paske lënë ti.

Ç'u bë rinia ime, në më pyeçi,
do t'ju përgjigjem shkurt:
— Seç pyetje! Heu!
Shikojeni, o miq, si shndrit ajo,
atë si medalion e mban atdheu.

UNË, STUDENTI

Unë vij nga malet kreshtëmurmë,
ku mbi shkëmb shqiporja sqepin mpreh.
Ky qytet plot njerëz dhe plot zhurmë,
ndjej sikur veç mua sot më sheh.

S'kam takuar kurrë rrjedhë jetë
me kaq drita, parqe dhe ndërtesa.
Një valixhe druri mbaj me vete.
plot me pemë, libra dhe ndërresa.

I kam hequr rrobat e shajakta
dhe opinga lope më nuk vesh,
por, në s'di t'i hedh aq butë hapat,
ti, djalosh i krehur, mos më qesh.

Dhe, në s'di ta lidh kravatën mirë,
ti, «zonjushe» talljen kot e fsheh,
sepse kaun di ta kap për brirë
edhe në parmandë vrapi ta mbreh.

Tok me ty në bankë mund të ulem,
delikatja shoqe, mos u tremb,

po të duash ti, të tregoj unë
se si mbin një lule përmbi shkëmb.

Unë vij prej maleve kreshtëashpër,
nga një stan i vogël unë vij:
nëna ime tjerr tani pas vatrës,
ati fle në pyllin me lajthi...

* * *

Përmbi Dajt del hëna si një vetull,
dielli ra përtej, n'Adriatik,
«Milosaon» kam tani nën sqetull
dhe mes kodre shkoj për në konvikt.

...Mbi antenat, shtyllat dhe çatitë
nata zbrejt si shpend, po s'mund të ndalet,
s'mund të ndalet dot ky shpend i hirtë
se e zbojnë larg hidrocentralet.

Muskuj dhe metal kërkojn' uzinat
(klubet ndjejnë mall për anekdota),
një karvan i kuq autobuzash
plogështin' e natës shtyp nën rrota.

Tituj filmash feksin anës rrugës,
një roman i bukur del në shitje,
përkundrejt pallatit të kulturës,
minareja hesht si pikçuditje.

Si një shkrep, ngarkuar me llambadha,
ndrit mbi kodër Universiteti,
rrotull tij, pas shtyllave të bardha,
mbrëmja ndan lirikat e studentit...

* * *

Për kohra, breza dhe për gjurmë
dëgjoj kur pedagogu flet,
kapitull i një libri jam dhe unë,
që hyj e dal në fakultet.

* * *

Si u ndodhëm ne kështu përballë,
si u lidhëm kaq papritur ne?
Ti me ndrojtjen time qesh e tallesh,
unë duart s'di se ku t'i fsheh,

Hap pas hapi, pyjeve, ndër netë
e kam ndjekur ujkun plot guxim,
po si mund të ndodhka që kaq lehtë
të më mundësh ti me një vështrim?

Dhe ç'enigm' e ëmbël më mban lidhur
që po gdhënd shpesh emrin tënd me brisk?
E përtypja Nolin dhe Shekspirë,
veç me syt' e tu e paskam pisk!..

* * *

Herët apo von' erdha në botë?
«S'je as von' as heret», ma pret toka.
S'më mjaftoka vetëm grusht' i fortë,
vetëm shpirt i butë s'më mjaftoka!

Ma ka shkruarjeta që tani
t'i bëj ara buke këto kreshta,
dhe, si plis që s'ngopet dot me shi,
unë s'ngopem dot me këto rreshta... .

Herët apo von' erdha në jetë?
«Je në kohë», ndjej plot zëra rrugës.
S'është mjaft q'lexon në mijra fletë,
po s'ta vau supin rrip i pushkës.

Ja kështu, për udhë larg u nisa,
si student, si bujk dhe si ushtar
si një bisk që kokën nxjerr ndër plisa
mes duarësh pushkën do ta marr.

* * *

Vajz' e re, mos pret dhe ti diçka
të të flas për katundin dhe pyjet?
Ç'sheh si ato lulet e mëdha,
që nga vetë dielli kthejnë kryet?

Po mos u trëmb nëse në këto net
do ta përzjej me vdekje dashurinë,
se mua, që kur isha dhjetë vjet,
një vdekje më rëndoi si gur mbi shpinë...

Përpara dhjetë vjetësh çunak isha,
më merrte ati im me dhen,
më griseshin opingat dhe këmisha,
plagët m'i lëpinte i miri qen.

Në mjegull, ujqërit në mal
zvariseshin të rrept' e të pabesë,
po qeni im, i madh sa një gomar,
e mbronte mirë nderin e kopesë.

Një natë — oh, q'e zezë natë! —
kur vetëm bishat pyjeve nuk flenë,

dikush erdh' e kërkoi tim atë,
dhe unë mbeta vetëm, me kopenë.

E prita gjersa shuhën yjtë,
pastaj, në ankth, u nisa ta gjej vetë.
Vështroja qenin, qeni ulte sytë,
sikur më mbante kyçur një të fshehtë.

Të shtrir' e gjeta pranë një borige,
me trup të ftohur krejt, fytyrëzverdhur:
pas shpine kishte shënja thike,
dhe syt' e zinj ja kishin vjedhur.

E bëra dorën grusht të merrja hakë.
Po q'mund të bëja unë dhjetëvjeçari?
Vështrova tej kufirit të mjegullt e të largët,
nga zhdukeshin dhe gjurmët e kusarëve.

Kur para trupit tij më gjunj' u ula,
një rrudhë ma preu ballin tim të njomë,
ndaj kurre s'do të pres të më përqeshë nata,
një nat' e mbarsur tej kufirit tonë.

Ndaj hedh në çast kapotën e ushtarit,
kur më thërret në zbor ky zëri i trumbetës.
Nuk dua nesër nga plumbi i tradhtarit
të bjesh, kur del nga porta e palestrës.

* * *

Ndaj u bëmë ne të dy kaq t'afërt,
ndaj u shkrimë tok në një mendim.

Ja, po çel një botë e panjohur
dhe guximshëm shkel n'atë drejtë.

Ati yt më sheh përmes gjyslykësh,
belbëzon diçka sa për t'u dukur,
pérshëndetj' e tij e shtirë qenka,
kurse unë i çiltër si bir bujku.

Nëna jote mbahet hijerëndë,
me romuze e pyetje po të mbyt,
sikur thotë: «Korbë, të kesh mendjen,
mos na bëhet ky skifteri yt...»

Ndofta imbi shezlong, pas perdesh tyli,
pret ndonjë «dhëndrrush» plot sqim' e bujë,
un' hyj befas n'ëndërrzat e tyre
dhe çdo plan ua prish, ua bëj rrëmujë.

E më shkrep që njerëzve meskinë
rreptë t'ua përplas un' lidhjen tonë,
ndërsa ti na sjell nga dhoma fqinjë
një shirit të ri manjetofoni:

«Po rend një flutur krahëlehtë
mes degësh pa kujdes,
një merimag' e kap me rjetë
oh, flutura ç'po vdes!...

Po unë degët fort i shkund
dhe gjethet i përhap,

çdo fill tē fshehur e këput
dhe flutura rend prapë».

Një çast vështrimi ty tē mbeti
pas fluturës, pas rjetës.
Mos vallë gjete tek insekti
një pjesë tē vetvetes?..

* * *

Dhe tani mund t'ecim krah për krah,
ku, nga këng' e re, dhe shkëmbi thyhet...
Ç'sheh si ato lulet e mëdha,
që nga vete dielli kthejnë kryet?

* * *

S'fle konvikti,
shokët paskan ethe,
nën çdo sy vizor një rrëth mavi.
Ka provim,
motivet studenteske
kushedi ku bredhin në vetmi.

Mbi «Ç'të bëjmë» dhjetra koka krrusen,
stolin bosh në park e tall veriu.
Kush s'i merr me mend berjoskat ruse,
nën tē cilat shpesh krijoj Gjeniu¹⁾?

Mbi tē tjera libra zbardhin shpata,
një rrëqethje briri nga larg vjen:

Roma dehet,
flagë nxjerr Ellada,
humbjet shfren Sulltani në harem.

Pa kur hyn gaztori i konviktit,
salla zjen nga këngë dhe shaka,
veç ndonjë «peshkop», që s'lot nga vendi,
konspekton «betejat e mëdha».

Hëna-gondol...

Shokët me shpirt qeshin,
gjer n'agim ndriçon pallati ynë.
Çast provimesh!

Nota, pas çdo rreshti,
si dinake e bukur na shkel synë.

* * *

Na zuri muzgu përmbi kodër,
në një bot' èndrrash dhe përrallash.
Mes shelgjesh dridhet gjol i vogël,
si sy i bukur mes qepallash.

Ne heshtim, heshtim. Pa kujuar,
një shpend na brofi pas një drize.
E trembur ti m'i hodhe duart,
pa ndenjëm ngjitur... e s'lëvize.

Hutimi ynë aqë zgjati,
sa zgjat një vetëtimë vere,
dhe ti, nga turpi dhe inati,
ja hodhe fajin asaj ferre.

* * *

Që i vogël, zbardhur krejt në brymë,
e kam gdhir' i vetëm ledh më ledh.
Dhe, kur pyll i fjetur s'merrte frymë,
kam dëgjuar bufin që të ngjeth.

Po s'u tremba kurrë nga vëtmia,
ndonse pak nga bota merrja vesh,
ndaj tani, mbi shpatullat e mia,
ti si shqerk' e bardhë mund të flesh...

Kur mbi gjoks ti kryet ma mbështet,
mijëra zilka — gjethesh troket plepi.
Dhe natyra nxjerr nga xhepi i vet
hënën si pasqyrëz tualeti...

Kush vështrimin tënd e rrökullisi
mbi fosforin' e shifrave të orës?
Pse t'u vrejt kjo vetull, që lëvizi
si agrep nervoz në puls të dorës?

Se vërsnikët tanë s'paskan fjetur,
zjarre partizane rrötull ndezin.
Shqetësohesh ti mos kemi mbetur
ne të dy në bisht të këtij brezi.

Dhe mendon se ç'shkuan dhe sa vijnë
shumë shpresa lidhën te ky brez,
grushtin mbledh, se shoqja moshatare
sonte vdes në frontin vietnamez.

Ndaj s'e ndjen kur vesa t'i njom flokët,
ndjen si koha ikën me galop,

do pa tjetër që dhe ne të ndrisim
si një llamb' e kuqe përmbi glob.

Do pa tjetër që dhe ne, në radhë,
të përshkojmë baltra, udhë, shpate
mbi kurrise malesh mjekërbardhë,
si dikur aradhat partizane.

* * *

Po mall' i vendit cil' s'e mori?

Cil mall' i madh s'e mundi?

Tani po futem tek sinori
kur fle i gjith' katundi.

Veç qen' i plakur e i lodhur
zgërdhiu e shpërvesh dhëmbët.
m'u hodh në fyt,
por, kur më njoihu,
më ra si skllav ndënë këmbët...

* * *

«Nënë, nesër më zgjo që me natë»,¹⁾

Kur rreh krahët mbi çerdhe fajkoi.

Do ta flak në një qoshe kravatën,
tok me shokët në mal do të shkoj.

Buk' e kazmë m'i var prapa portës
Edhe balon plak të zgjidhur lere

1) Varg i Eseninit

sot edhe flokët e prerë pas modës
më ka shkrepur t'i kreh si athere.

Zgjomë, mos u prek nga dhëmshuria.
ty për gjumin mos t'ardhtë hiç keq.
Përtej lumit do dal', te koria
ku kam zënë mëllinja me leq.

Eja, eja dhe ti n'ato udhë,
m'afër diellit n'agim të të ngjit!
Këngët tonë ta fshijnë çdo rrudhë.
vrulli ynë dhe foshnjat i rrit.

Dhe mbështetu pas ëndrrave tonë,
që s'i ulëm nga lart mbi pëllëmbë,
por i ngrohim, si vezët shqiponja,
mes shkëmbinjve, me punën e rëndë.

Mbylli sytë, ëndërrro ti për t'ardhmen,
flokbardhosheja ime, dhe qesh.
Fëshfëritje të lashtash dhe pemësh
rreth katundit të xhveshur të ndjesh.

A s'të ngjan sikur buk' e lakrorë
po na sjell në arat mbi taraca,
ndërsa rreth blegërijnë në kor
dhen pëlleja e rude leshëbardha?

Un', yt bir, m'i fuqishëm, m'i mprehtë.
që nga thelb' i atdheut po vi,
ati im, ëndërronjës, i lumtur
le të prehet tanë nën lajthi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. KËNGË PËR ATDHEUN, PARTINË DHE SHOKUN ENVER

Vargje për partinë dhe shokun Enver — <i>Ylli Zaho</i>	5
Moshatares Republikë — <i>Zhuljana Jorganxhi</i>	8
Partisë — <i>Ndrekë Gjergji</i>	9
Enverit — <i>Kujtim Sulaj</i>	10
Partisë — <i>Faik S. Deda</i>	12
Të dashurit Enver — <i>Faik S. Deda</i>	13
Këngë për Partinë — <i>Shaban Marati</i>	15
Moshatarëve të Atdheut — <i>Shaban Marati</i>	16
Atdheu — <i>Ramazan Hushi</i>	18
Qyteti im — <i>Stefan Kume</i>	19
Për Republikën — <i>Pullumb Murati</i>	20
Gëzuar Vitin e Ri! — <i>Pullumb Murati</i>	22
Atdheut — <i>Vangjel Stefa</i>	24

II KËNGË PËR HERONJ

Perlat Rexhepi — <i>Ylli Zaho</i>	29
Ashtu si Adem Reka — <i>Ylli Zaho</i>	30
Përmes flakës — <i>Ilo Niço</i>	31

III. KËNGË PËR VULLNETARËT

Aromë pishash — <i>Niko Dako</i>	35
Mall — <i>Marte Qesteri</i>	42
Duart e mia — <i>Marte Qesteri</i>	43
Studentët vullnetarë — <i>Martin Cukalla</i>	44
U nisën vullnetarët — <i>Maksim Kroji</i>	46
Duke ecur përmes fushave me tren — <i>Halil Lalaj</i>	48
Gjithë e duan komandantin — <i>Betim Muço</i>	49

Eh, si ishin këto kodra!.. — <i>Betim Muço</i>	51
Ne, vullnetarët — <i>Ndreke Gjergji</i>	53
Përshëndetje vullnetarëve — <i>Sami Bogdani</i>	54
A e dëgjoni, vullnetarë të rinj? — <i>Viktor Qyrku</i>	56
E, hënë, si thua? — <i>Viktor Qyrku</i>	58
Marshojmë dhe këndojojmë — <i>Shaban Marati</i>	59
Taracat — <i>Stefan Kume</i>	60
Rruja e rinisë — <i>Sokrat Kotherja</i>	61
Katundare, katundare — <i>Palokë Rrotani</i>	62
Shokëve të mi, vullnetarë — <i>Ylli Zaho</i>	63
Kënga moshatare — <i>Spiro Dede</i>	65

IV. KËNGË PËR PRINDIN E MËSUESIN

Këngë dashurie për babanë — <i>Xhevair Spahiu</i>	73
Mësueses së klasës së parë — <i>Marte Qesteri</i>	81
E dashur nënë! — <i>Nevruz Binaj</i>	82
Ju, baballarët tanë — <i>Stefan Kume</i>	83
Mësuesi — <i>Bahri Tafa</i>	84

V. KUNDRA BESTYTNIVE FETARE

Në kishë — <i>Stefan Kume</i>	87
Koha dhe feja — <i>Pullumb Murati</i>	88
Për Republikën — <i>Pullumb Murati</i>	89
Çou «i lumi krisht» — <i>Ylli Zaho</i>	91
Tri dyer — <i>Ndreke Gjergji</i>	94
Kisha e Rubigut — <i>Halil Lalaj</i>	97

VI. TE NDRYSHME

Skënderbeu — <i>Hiqmet Meçaj</i>	101
Mendime pranë stanit — <i>Faik S. Deda</i>	103
Kujtime — <i>Bardhyl Londo</i>	107
Topi i muzeumit — <i>Bardhyl Londo</i>	108
Moshatarët — <i>Bahri Tafa</i>	109
Sonte — <i>Halil Lalaj</i>	110
Natë vietnameze — <i>Javer Beqiraj</i>	111
Vargje për heroin vietnamez — <i>Betim Muço</i>	113
Për rininë time — <i>Betim Muço</i>	115

Endrra të pavdekshme — <i>Zhuljana Jorganxhi</i>	117
Malësori i «Legjendës së misrit» — <i>Koçi Petriti</i>	119
Era e tokës — <i>Kujtim Sulaj</i>	121
Në rrugët e Mirditës — <i>Martin Çukalla</i>	122
Mbi ty, Vau i Dejës — <i>Ndrekë Gjergji</i>	124
Në qytetin e studentëve — <i>Ramazan Hushi</i>	125
Fletë-rrufetë — <i>Stefan Kume</i>	126
Vargje çobane — <i>Ylli Zaho</i>	127

VII. POEMA

Këngë për njeriun e ri — <i>Hiqmet Meçaj</i>	131
Unë, studenti — <i>Koçi Petriti</i>	143

43432

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS
GJYMTHIKALE